



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7
Nr. ____/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “LETËRSI” ARSIMI I MESËM I LARTË KLASA 10

FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinatore: Erida Koleci



PËRMBAJTJA


I. HYRJE.....	4
II. QËLLIMET E LËNDËS SË LETËRSISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË	6
III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË LETËRSISË.....	8
IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E LETËRSISË.....	10
4.1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit.....	10
4.2. Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e letërsisë	17
4.3. Kompetencat e lëndës së letërsisë dhe rezultatet e të nxënit	19
V. PËRMBAJTJA MËSIMORE E KLASËS SË DHJETË	22
5.1 Koha mësimore në klasën e dhjetë.....	22
5.2 Përmbajtja mësimore e klasës së dhjetë.....	22
5.3 Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).....	35
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	38
6.1. Parimet e mësimdhënies së letërsisë.....	38
6.2. Metodat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave letrare.....	40
6.3. Elementet që do të studiohen në tekstet letrare	41

6.4. Autorët, veprat dhe fragmentet e sugjeruara në lëndën e letërsisë	44
6.5. Bisedat letrare	44
6.6. Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e letërsisë	45
6.7. Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e letërsisë	47
6.8. Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e letërsisë	48
7. VLERËSIMI I NXËNËSVE	50
7.1. Parimet e vlerësimit në lëndën e letërsisë	50
7.2. Llojet e vlerësimit në lëndën e letërsisë	51
7.3. Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të nxënësit	57
7.4. Procedurat e vlerësimit në lëndën e letërsisë	58
8. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE	58
8.1. Përdorimi i teknologjisë në lëndën e letërsisë	59
8.2. Roli i bibliotekës së shkollës	60
9. REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT	62
10. NDRYSHIME PËRMBAJTJESORE	66

I. HYRJE

Lënda e letërsisë bën pjesë në fushën e të nxënit “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët e kurrikulës bërthamë: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë angleze, dhe nga lëndët e kurrikulës me zgjedhje: Gjuhë shqipe me zgjedhje, Letërsi me zgjedhje dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe letrare të nxënësve, duke i aftësuar ata për të kuptuar dhe për të përpunuar mesazhe të ndryshme; për të komunikuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të përshtatshme; për të menduar në mënyrë të pavarur dhe kritike; për të krijuar tekste të ndryshme; si dhe për të pasuruar kulturën letrare. Gjithashtu, nëpërmjet mësimi të gjuhës dhe të letërsisë, nxënësit zhvillojnë imagjinatën dhe krijimtarinë, ndjeshmërinë estetike dhe aftësinë për të përjetuar të bukurën, për të vlerësuar dhe për të gjykuar në mënyrë të thelluar veprat artistike dhe shprehjen njerëzore. Kjo fushë u mundëson nxënësve të ndërtojnë një marrëdhënie të vetëdijshme me gjuhën dhe artin e fjalës, duke u formuar si qytetarë të përgjegjshëm, krijues dhe të angazhuar në jetën kulturore dhe shoqërore. Letërsia, si një nga lëndët kryesore të kësaj fushe, luan një rol të veçantë në formimin intelektual, estetik dhe kulturor të nxënësit. Ajo ndërton ura mes nxënësve dhe përvojës njerëzore të mishëruar në veprat letrare.

Në arsimin bazë, letërsia mësohet e integruar me lëndën e gjuhës shqipe dhe përdoret për të zhvilluar aftësitë e të lexuarit, e të kuptuarit dhe e të shprehurit me vetëdije, si dhe imagjinatën, duke krijuar kontaktin e parë të nxënësve me tekstin letrar dhe elementet e tij përfaqësuese. Në arsimin e mesëm të lartë, letërsia zhvillohet si lëndë më vete, me qëllime të pavarura dhe qasje të thelluar ndaj përmbajtjes artistike. Kjo ndarje i jep letërsisë statusin që i takon, si një veprimtari estetike dhe reflektuese, e cila nuk synon thjesht përvetësimin teknik të gjuhës, por ndërtimin e një përvoje të thellë me veprën letrare, përmes analizës, interpretimit dhe vlerësimit të saj duke iu referuar edhe kontekstit historik, shoqëror dhe filozofik.



Qëllimi i programit të lëndës së letërsisë është që nxënësit të përjetojnë letërsinë si një formë arti dhe si një mënyrë e të menduarit për jetën. Ata duhet të mësojnë të ndërtojnë marrëdhënie të drejtpërdrejta me tekstin letrar, të zhvillojnë ndjeshmëri estetike, të kuptojnë strukturën dhe përmbajtjen e veprave në thellësi, si dhe të formojnë gjykime të pavarura. Letërsia nuk paraqitet si një seri njohurish enciklopedike, por si një proces i vazhdueshëm kuptimi, përjetimi dhe krijimi personal.

Në këtë kuadër, programi i letërsisë synon ndërtimin dhe zhvillimin e dy kompetencave lëndore:

- *Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare*, me qëllim që nxënësi të kuptojë strukturën, përmbajtjen, figuracionin dhe mesazhet e teksteve letrare, si dhe të ndërtojë qëndrim personal ndaj tyre.
- *Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe i letërsisë botërore në periudha të ndryshme letrare*, për të njohur zhvillimet letrare dhe për të ndërtuar ndjeshmëri ndaj trashëgimisë letrare shqiptare dhe botërore.


Nëpërmjet zhvillimit të këtyre kompetencave lëndore, programi i letërsisë (si çdo program lëndor në arsimin parauniversitar) kontribuon gjithashtu në ndërtimin dhe në përforcimin e kompetencave kyç të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, të domosdoshme për përmbushjen e kërkesave personale, shoqërore dhe profesionale të individit në shoqërinë bashkëkohore.

Lënda e letërsisë zhvillohet si një përvojë që kërkon përfshirje të plotë të intelektit, ndjenjës dhe imagjinatës. Tekstet përzgjidhen në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve, si dhe me kërkesat për të lexuar vepra që nxisin reflektimin, analizën dhe shprehjen krijuese. Mësimi i letërsisë mbështetet në diskutime, në përpunim personal të kuptimeve dhe në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme me tekstin letrar dhe me leximin.

Programi i letërsisë, në këtë mënyrë, kontribuon në formimin e nxënësit si qytetar i ndërgjegjshëm, si lexues i thellë dhe si individ i aftë të mendojë dhe të komunikojë në mënyrë krijuese dhe të pasur në realitetin bashkëkohor.

II. QËLLIMET E LËNDËS SË LETËRSISË NË ARSIMIN E MESEM TË LARTË

Lënda e letërsisë u jep nxënësve mundësinë të përjetojnë tekstin letrar si një mjet për të kuptuar më mirë veten, të tjerët dhe botën. Përmes leximit, interpretimit dhe vlerësimit të veprave letrare, nxënësit frymëzohen të mendojnë thellë, të ndjejnë empati, të zhvillojnë imagjinatën dhe të formulojnë mendime të argumentuara mbi realitetin njerëzor dhe sfidat shoqërore. Letërsia i ndihmon ata që të ndërtojnë vetëdije kulturore, estetike dhe qytetare, si dhe t'u japin zë mendimeve e ndjenjave të tyre në mënyrë krijuese dhe kritike.



Lënda e letërsisë ka për qëllim që nxënësit:

- të lexojnë dhe të interpretojnë vepra letrare nga autorë shqiptarë dhe botërorë, përfaqësues të periudhave dhe të drejtimeve të ndryshme letrare.
 - të dallojnë dhe të analizojnë tiparet themelore të gjinisë epike, lirike dhe dramatike, si dhe të kuptojnë strukturën, stilin dhe funksionin e tyre artistik.
 - të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar dhe interpretuar temat, idetë, simbolikat dhe vlerat që përcjell një tekst letrar, në lidhje me kontekstin e krijimit dhe me aktualitetin.
 - të bëhen të vetëdijshëm për mënyrat e ndryshme se si njerëzit mendojnë, ndjejnë dhe jetojnë në kultura dhe në periudha të ndryshme, duke ndërtuar ndjeshmëri ndaj tjetrit dhe aftësi për të rishikuar bindjet personale.
 - të vlerësojnë letërsinë si një formë arti që pasuron përvojën estetike, nxit të menduarit kritik dhe krijues, si dhe forcon identitetin gjuhësor, kulturor dhe kombëtar.
- të kërkojnë dhe të përdorin prova, dëshmi ose shembuj nga teksti për të mbështetur këndvështrime dhe përfundime, si dhe të identifikojnë paragjykimet, interpretimet e mundshme dhe përdorimin e papërshtatshëm të provave.
 - të krahasojnë në mënyrë kritike vepra apo fragmente letrare, duke analizuar temat, stilin, personazhet, kontekstin e tyre etj.
 - të lidhen me tekstin në mënyrë personale dhe reflektive, duke nxjerrë kuptime për jetën e tyre, realitetin përreth dhe sfidat globale.

- të shprehin ndjenja dhe mendime përmes formave të ndryshme të komunikimit letrar (ese, analizë, krijim letrar), në mënyrë të qartë, krijuese dhe të argumentuar.
- të vendosin lidhje mes letërsisë dhe arteve të tjera (muzikë, pikturë, teatër, film), duke kuptuar ndërveprimin ndërartistik dhe dimensionin ndërdisiplinor të përvojës estetike.
- të ndërtojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me leximin si proces njohës, emocional dhe estetik që i ndihmon në rritjen personale, në përgatitjen për jetën qytetare dhe në zhvillimin profesional të mëtijshëm.

Si do të marrin formë konkrete qëllimet e lëndës?

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit dhe mësuesit përfshihen në mënyrë aktive me tekstet dhe bashkëpunojnë në procesin e ndërtimit të kuptimit. Edhe pse nxënësit mund të lidhen personalisht dhe në mënyrë reflektuese me tekstet, është e domosdoshme që ata të shprehin mendimet e tyre përmes dialogut dhe shkrimit, për të nxitur një diskutim domethënës rreth teksteve. Zbulimi i proceseve të brendshme që përfshihen në ndërtimin e kuptimit dhe theksimi i rolit të dialogut dhe shkrimit në klasë është i rëndësishëm. Nxënësit duhet të përfshihen aktivisht me tekstin, duke lexuar me vëmendje, duke bërë pyetje, duke menduar në mënyrë kritike dhe duke formuluar interpretime të mbështetura në tekst.


Ndërkohë, mësuesit duhet të marrin rolin e lehtësuesit të të nxënit, në vend që të mbeten në rolet tradicionale si shpërndarës informacioni apo ofrues të gjykimeve përfundimtare. Ata duhet të nxisin pjesëmarrjen e nxënësve, t'u drejtojnë pyetje të hapura dhe sfiduese, të udhëheqin diskutime dhe të mbështesin zhvillimin e shprehjes së mendimit personal me argumentim të bazuar.

Qëllimet e lëndës marrin formë konkrete përmes aktiviteteve të shumta që zhvillohen në klasë, si: analiza e thelluar e teksteve, shkrimi i eseeve, debatet dhe diskutimet letrare, krahasimi i veprave, lidhja me arte të tjera dhe krijimtaria personale. Përmes këtyre proceseve, nxënësit jo vetëm kuptojnë tekstin, por mësojnë të mendojnë, të ndjejnë dhe të komunikojnë në mënyrë më të vetëdijshme, më të ndjeshme dhe më të aftë.

Në këtë mënyrë, qëllimet e lëndës realizohen përmes një mësimdhënieje të përqendruar te nxënësi, e cila i jep përparësi përjetimit, reflektimit dhe komunikimit të mendimit të pavarur, duke shndërruar lëndën e letërsisë në një hapësirë të gjallë të dialogut kulturor dhe të zhvillimit personal.

III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË LETËRSISË

Programi i letërsisë synon të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e kompetencave letrare dhe të kompetencave kyç, përmes përfshirjes së nxënësve në përjetimin, analizën, interpretimin dhe vlerësimin e veprave letrare nga letërsia shqipe dhe ajo botërore. Në thelb, ky program synon të formojë individë të ndjeshëm, krijues dhe kritikë, të aftë për të kuptuar përvojën njerëzore përmes artit letrar, për të ndërtuar qëndrime të vetëdijshme ndaj realitetit dhe për të zhvilluar ndjeshmëri estetike. Programi i lëndës së letërsisë në arsimin e mesëm të lartë përmban këto rubrika:



Qëllimet e lëndës

Përcaktohen qëllimet e lëndës për arsimin e mesëm të lartë, duke u përqendruar në zhvillimin e aftësive për të kuptuar, interpretuar analizuar dhe vlerësuar tekstin letrar, për të ndërtuar gjykime estetike dhe etike, për të nxitur imagjinatën, mendimin kritik dhe shprehjen krijuese.

Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Tregohet mënyra se si lënda e letërsisë kontribuon në zhvillimin e kompetencave kyç përmes kompetencave të saj specifike, si dhe paraqiten rezultatet e të nxënit të lidhura me to.

Temat ndërkurrikulare

Shpjegohet roli i letërsisë në trajtimin e temave ndërkurrikulare, si: identiteti kombëtar, qytetaria aktive, zhvillimi i qëndrueshëm, teknologjia dhe media, si dhe shëndeti emocional dhe social.

Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit

Përshkruhen kompetencat lëndore të letërsisë dhe paraqiten rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë, të ndara sipas njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që pritet të zhvillohen.

Përmbajtja mësimore

Përcaktohet koha mësimore në klasën e dhjetë dhe sugjerohet një ndarje orientuese e orëve. Paraqitet përmbajtja përmes veprave ose fragmenteve përfaqësuese, të shoqëruara me zbërthimin e rezultateve të të nxënit sipas njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve.

Metodologjia e mësimdhënies

Përcaktohen parimet që duhet të udhëheqin mësimdhënien e letërsisë. Jepen sugjerime për metoda dhe teknika si analiza letrare, shkrimi krijues, debati, lidhja ndërtekstuale, si dhe puna me nxënësit me nevoja të veçanta dhe me nxënësit e talentuar.

Vlerësimi i nxënësve

Përshkruhen format e vlerësimit të nxënësve, përfshirë vlerësimin për të nxënë dhe vlerësimin e të nxënit, si dhe instrumentet e vlerësimit të përshtatura për lëndën e letërsisë (analiza, ese, projekte, diskutime letrare). Jepen shembuj të niveleve të arritjes për disa nga rezultatet e të nxënit.

Burimet dhe materialet mësimore

Përcaktohen burimet e të nxënit që mund të përdoren gjatë procesit mësimor, përfshirë veprat letrare, tekstet digjitale, antologjitë, filmat, shkrimet kritike, si dhe roli i bibliotekës shkollore dhe i teknologjisë në mbështetjen e leximit dhe interpretimit të thelluar.

Rekomandime për zbatimin e programit

Jepen rekomandime për përdoruesit e programit: mësuesit (për planifikimin e mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësve), hartuesit e teksteve shkollore, autorët e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm, prindërit (për të mbështetur fëmijët e tyre) dhe vetë nxënësit (si lexues dhe krijues të angazhuar).

Ndryshimet përmbajtjesore

Përshkruhen risitë dhe përditësimet kryesore të përfshira në këtë program të letërsisë, në raport me programin e mëparshëm.

IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E LETËRSISË

4.1.Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Në vitet e ardhshme, nxënësit do të përballen me një treg pune dhe një realitet shoqëror që ndryshon me ritme të shpejta. Automatizimi në rritje, përparimet teknologjike dhe dinamikat e një ekonomie globale po e transformojnë mënyrën si jetojmë, mësojmë dhe punojmë. Për këtë arsye, përgatitja e nxënësve për të qenë fleksibël, për të ndryshuar e rikrijuar orientimin e tyre profesional dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive si qytetarë të ndërgjegjshëm në një botë të globalizuar dhe digjitale është më e rëndësishme se kurrë.

Në këtë kontekst, zhvillimi i kompetencave kyç dhe i dëshirës për të mësuar gjatë gjithë jetës bëhen themeli i suksesit të tyre personal, profesional dhe shoqëror. Kompetencat kyç përfaqësojnë një kombinim të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve që i ndihmojnë nxënësit të përballen me sfidat e së tashmes dhe të ardhmes, të përshtaten ndaj ndryshimeve dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën ekonomike, kulturore e qytetare.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar përcakton tetë kompetenca kyç që synohen të ndërtohen dhe zhvillohen gjatë gjithë niveleve të arsimit parauniversitar. Ato janë:

- Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare

- Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
- Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
- Kompetenca digjitale
- Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit
- Kompetenca qytetare
- Kompetenca e sipërmarrjes
- Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

Këto kompetenca nuk zhvillohen në mënyrë të ndarë nga përmbajtjet mësimore, por integrohen në të gjitha lëndët dhe aktivitetet shkollore, përmes një procesi të qëndrueshëm, të ndërveprueshëm dhe gjithëpërfshirës. Lënda e letërsisë jep një kontribut të veçantë në zhvillimin e shumë prej tyre, veçanërisht në komunikim, mendim kritik, ndjeshmëri kulturore, qytetari të vetëdijshme dhe shprehje krijuese.

Mësuesit luajnë një rol kyç në lehtësimin e këtij procesi, përmes përdorimit të metodave të përshtatshme, qasjeve të orientuara drejt nxënësit dhe formave të ndryshme të vlerësimit, në një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë. Për të mbështetur mësuesin në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e kompetencave, ato janë zbërthyer në rezultate të të nxënit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç, që mund të zhvillohen në lëndën e letërsisë në klasën e dhjetë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në klasën e dhjetë

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhët e huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkrues në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - komunikon në gjuhë të huaj, pyet për të identifikuar qëllimet e përbashkëta, krahason opsionet e ndryshme dhe jep sugjerime se çfarë duhet bërë më tej.

- përdor dhe dallon lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë tekstet digjitale. - ndërton identitetin e tij kulturor dhe gjuhësor, si dhe vlerëson trashëgiminë gjuhësore amtare. - përdor gjuhën për të krijuar dhe për të vlerësuar krijime artistike, të cilat shprehin emocionet, përjetimet dhe idetë e tij. - shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim ose në një interpretim për tema nga fusha të ndryshme, përmes së paku një forme komunikimi. - diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje, për një temë të caktuar në gjuhën amtare. - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare në tekste të ndryshme. - shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, profesioni, shoqëria dhe mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim. - përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut dhe IA-në gjatë procesit të të nxënit.	- përcjell informacion dhe jep argumente brenda fushave të tij të interesit profesional, akademik dhe personal. - shkruan qartë tekste për një sërë temash që lidhen me fushën e tij të interesit, duke zgjeruar dhe mbështetur idetë me shpjegime dhe shembuj përkatës. - lexon, kupton dhe prodhon tekste, përfshirë tekstet digjitale. - respekton dhe vlerëson gjuhët dhe kulturat e vendeve të tjera. - vlerëson se si ndryshimet kulturore ndikojnë në përdorimin dhe komunikimin e gjuhës. - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës së huaj, në një numër të caktuar tekstesh, si: ese, e-mail, letra formale dhe joformale etj. - shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim. - përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut, aplikacionet digjitale dhe IA-në gjatë procesit të të nxënit.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale

<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - zbaton proceset themelore matematikore në kontekstet e përditshme të jetës reale, përfshirë ato financiare. - kupton vërtetimin matematik. - komunikon me gjuhën matematikore. - përdor mjete ndihmëse të përshtatshme, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe grafikët. - përdor mjetet dhe pajisjet teknologjike. - hulumton natyrën përmes eksperimenteve të kontrolluara. - përdor të dhëna shkencore për të arritur një qëllim, për të marrë një vendim ose për të nxjerrë një përfundim bazuar në prova. - sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj. - gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti dhe i interpreton ato me gjuhën e matematikës dhe të fushës përkatëse, i paraqet grafikisht ose në formë tabelore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., projekt me bazë shkolle, projekt për gjelbërimin, koncert, ekspozitë tematike, orë letrare, punë laboratorike etj.). - hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor, përzgjedh, përpunon dhe vlerëson përmbajtje digjitale. - interpreton dhe analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime të informuara. - identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale. - krijon, programon dhe shpërndan përmbajtje digjitale. - menaxhon dhe mbron informacionin, përmbajtjen, të dhënat dhe identitetet digjitale. - përdor mjete digjitale për të prodhuar, për të paraqitur dhe për të kuptuar informacione komplekse. - njeh softuerët dhe pajisjet. - kupton dhe përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe për të interpretuar të dhënat dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme. - përdor teknologjinë digjitale për të krijuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët. - demonstroi aftësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbytjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënës (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, për përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve etj.). - përdor programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar
--	--

përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur TIK-un. - identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë. - vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe gjuhësor etj.). - argumenton rezultatet e arritura gjatë një eksperimentimi në shkollë apo diku tjetër, duke përshkruar qëllimin, hipotezën dhe mënyrën e vëzhgimit të dukurisë së manifestuar, si dhe rezultatet i paraqet në mënyrë tabelore dhe grafike.	me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit. - prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videosh, figurash për demonstrimin e temave mësimore. - tregon rregullat e sigurisë që duhen zbatuar për të ruajtur privatësinë personale sipas kodit të etikës së komunikimit personal dhe në grup.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të të nxënit, nxënësi:</i> - identifikon përparësitë dhe dobësitë personale, zhvillohet duke u mbështetur në përparësitë e tij dhe punon për kapërcimin e dobësive/mangësive. - organizon të nxënit, fokusohet dhe vendos qëllime.	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - angazhohet me të tjerët në çështjet publike. - tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti. - vlerëson diversitetet dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve.

- vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare. - motivon dhe vlerëson veten. - mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim. - komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip. - kupton ndjenjat, mendimet dhe perspektivat e të tjerëve. - menaxhon stresin, pasiguritë dhe zgjidh konfliktet ndërpersonale. - kupton dhe analizon mënyrën e jetës së shëndetshme. - shfrytëzon, në mënyrën e duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve. - bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes së burimeve të informacionit. - paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar, duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e prezanton para të tjerëve. - vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, si p.sh., në mënyrë të pavarur	- demonstroi vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh., respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjykitimeve dhe i diskriminimit të të gjitha llojeve, promovimi i barazisë gjinore etj.). - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë të paanshme. - demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore. - harton një listë propozimesh për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet. - prezanton në formë të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë. - ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikatat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve. - ilustron me shembuj, zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel komuniteti, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstroi mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore). - merr pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e një aktiviteti për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra
--	--

redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, e qartësisë së mendimit etj. - menaxhon në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një aktiviteti ose të një detyre të caktuar në një lëndë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.	të ndryshme kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të tij.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - mendon në mënyrë strategjike dhe zgjidh probleme. - përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese. - merr vendime financiare për koston dhe vlerën, si dhe çmon koston e shndërrimit të një ideje në një aktivitet që krijon vlerë. - planifikon, merr dhe vlerëson vendimet financiare. - përballet me pasigurinë, paqartësinë dhe rrezikun për vendimet që ndërmerr. - zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale. - ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve. - planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij, si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve. - shpreh dhe interpreton idetë, përvojat dhe emocionet me ndjeshmëri në arte të ndryshme dhe forma të tjera kulturore. - shijon dhe vlerëson veprat e artit. - shpreh veten në media të ndryshme, duke përdorur dhe përmirësuar kapacitetin personal. - identifikon dhe realizon mundësitë për të shprehur vlera personale, sociale ose tregtare nëpërmjet arteve dhe formave të tjera kulturore.

caktuara, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës. - përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një biznesi). - zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe të përdorimit të tyre.	
---	--

4.2.Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e letërsisë

Temat ndërkurrikulare janë elemente të rëndësishme të procesit mësimor dhe pasqyrojnë çështje aktuale e afatgjata që prekin jetën individuale dhe kolektive në shoqërinë bashkëkohore. Ato përfshihen në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe ndërthuren në të gjitha lëndët, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë ndërlidhjet midis njohurive, të ndërtojnë vizion të gjerë për botën dhe të marrin përgjegjësi në një mjedis global, digjital dhe të ndërlikuar. Në vijim paraqiten disa shembuj që tregojnë se si temat ndërkurrikulare integrohen në lëndën e letërsisë në klasën e dhjetë.

Identiteti kombëtar

Letërsia shërben si një nga format më të fuqishme të ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit kombëtar. Në klasën e dhjetë, nxënësit njihen me përfaqësues të letërsisë së vjetër shqiptare (Buzuku, Barleti, Bardhi, Budi, Bogdani) dhe me trashëgiminë gojore popullore (Eposi i Kreshnikëve,

këngët legjendare, përrallat etj.), përmes të cilave ndërgjegjësohen për rrënjët e tyre kulturore, për figurat themelore të historisë kombëtare dhe për rolin e letërsisë në ndërtimin e identitetit dhe të unitetit kombëtar.

Për shembull, nxënësit:

- analizojnë mënyrën si portretizohet figura e Skënderbeut në veprat e Barletit dhe Bardhit.
- krahasojnë temat e heroizmit në Eposin e Kreshnikëve me ato të “Iliada”, duke diskutuar vlerat përmbajtjesore që përcjellin.
- reflektojnë mbi gjuhën, simbolet dhe mesazhet e trashëgimisë gojore shqiptare si pjesë e identitetit kombëtar.

Qytetaria aktive dhe sipërmarrja

Përmes letërsisë, nxënësit njihen me modele veprimi, qëndrime kritike dhe dilema morale që kanë lidhje me përgjegjësinë individuale dhe pjesëmarrjen qytetare. Vepra si “Hamleti” i Shekspirit apo “Tartufi” i Molierit i nxisin nxënësit të reflektojnë mbi drejtësinë, hipokrizinë, vendimmarrjen dhe integritetin personal në përballje me pushtetin, mashtrimin dhe opinionin publik.

Për shembull, nxënësit:

- analizojnë dilemat morale të Hamletit në raport me drejtësinë dhe përgjegjësinë personale.
- diskutojnë si trajtohet mashtrimi dhe morali në komedinë “Tartufin” dhe i lidhin me fenomene të ngjashme në shoqëri sot.
- shkruajnë ose diskutojnë mbi rolin e individit në përmirësimin e jetës komunitare, duke u frymëzuar nga personazhet e veprave ose të fragmenteve të lexuara.

Shëndeti mendor, fizik dhe siguria

Letërsia krijon hapësirë për të kuptuar përvojat njerëzore në gjithë kompleksitetin e tyre emocional. Tekstet si “Gratë në parlament” apo tragjedia “Prometeu” ofrojnë kontekste për të reflektuar mbi presionin shoqëror, vuajtjen, lirinë individuale dhe qëndrueshmërinë shpirtërore.

Për shembull nxënësit:

- analizojnë ndjenjën e izolimit, luftën e brendshme dhe sakrificën të Prometeu apo të Hamleti.
- eksplorojnë mënyrën si përshkruhet ankthi, humori, absurdi dhe protesta në veprat klasike greke.
- diskutojnë rëndësinë e shprehjes së emocioneve dhe ndjeshmërisë për mirëqenien mendore.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Edhe pse në mënyrë indirekte, shumë vepra letrare u japin nxënësve mundësinë të reflektojnë mbi qëndrueshmërinë kulturore, përgjegjësinë ndaj natyrës dhe përballjen e individit me ndryshimet sociale dhe mjedisore. Për shembull, nxënësit:

- diskutojnë mbi ndëshkimin moral dhe rrugëtimin shpirtëror drejt shpëtimit, të “Komedia hyjnore”.
- diskutojnë ndikimin e qëndrimeve njerëzore në fatin e individit dhe shoqërisë në përballje me padrejtësinë dhe shkatërrimin.

Teknologjia, shoqëria dhe media

Edhe pse veprat e klasës së dhjetë u përkasin periudhave të hershme, ato ofrojnë baza të pasura për të diskutuar çështje bashkëkohore që lidhen me përhapjen e informacionit, ndikimin e mediave dhe etikën e komunikimit. Për shembull për komedinë “Tartufi”, nxënësit diskutojnë fuqinë e bindjes dhe të hipokrizisë në marrëdhëniet shoqërore, duke e lidhur me formimin e opinionit në media sot.

Shënim: Veprimtari praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3.Kompetencat e lëndës së letërsisë dhe rezultatet e të nxënësit

Lënda e letërsisë synon të formojë dhe zhvillojë te nxënësit dy kompetenca:

- Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për zhvillimin e këtyre kompetencave nuk bëhet e ndarë dhe e fragmentarizuar. Në procesin mësimor, gjatë çdo ore mësimore punohet për formimin e të dyja kompetencave. Kështu, p.sh., nxënësi analizon dhe interpreton tragjedinë “Hamleti”, duke shqyrtuar të gjitha veçoritë e saj artistike, si strukturën dramatike, temat dhe motivet, personazhet, konfliktet dhe figuracionin, dhe gjithashtu gjykon e vlerëson lidhjet e saj me krijimtarinë letrare të Shekspirit dhe me periudhën historike të Rilindjes.

Përshkrimi i kompetencave dhe rezultatet e të nxënësit

Në këtë rubrikë është dhënë një përshkrim i shkurtër i kompetencave. Çdo kompetencë është zbërthyer në rezultate të nxënësit.

Kompetenca lëndore	Përshkrimi i kompetencës	Rezultatet e të nxënit
Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.	Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë si në shkollë, ashtu edhe në jetë. Ata analizojnë, interpretojnë dhe vlerësojnë vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare, duke u formuar si lexues kritikë dhe të pavarur. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për të kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare nuk i mësojnë thjesht në mënyrë teorike, por i njohin të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe prozaikë. Në procesin e analizës dhe interpretimit të veprave, ata dallojnë edhe mjetet e shumta gjuhësore, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.	Nxënësi: - interpreton, analizon dhe vlerëson elementet kryesore të përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, duke dalluar temën dhe motivet, idetë, përshkrimin e kohës dhe të mjedisit, rrëfimtarin, marrëdhëniet midis personazheve, si dhe strukturën e fabulës dhe të subjektit. - interpreton, analizon dhe vlerëson një tekst poetik, duke identifikuar motivet dhe idetë kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës dhe veçori të tjera të formës artistike. - interpreton, analizon dhe vlerëson një tekst dramatik, duke shqyrtuar mënyrën e trajtimit të temës, natyrën e konflikteve, marrëdhëniet mes personazheve dhe elemente të tjera të tekstit dramatik. - dallon dhe vlerëson tiparet dalluese të secilës gjini letrare, duke kuptuar funksionin, mesazhet dhe vlerën e tyre artistike.
Vlerësimi i letërsisë shqipe	Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:	Nxënësi:

dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.	- të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, duke njohur proceset dhe prirjet kryesore që i kanë formuar ato. - të lidhjes mes veprave letrare dhe konteksteve historike e kulturore dhe mënyrës se si ndikojnë ato në veprat letrare. - të gjinive letrare, autorëve dhe veprave më përfaqësuese, duke i vendosur ato në raport me periudhat historike ose drejtimet letrare ku bëjnë pjesë. Mësimi i letërsisë synon të theksojë tiparet kryesore të një periudhe apo drejtimi letrar, duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë origjinën, zhvillimin dhe veçoritë e tij, si dhe gjinitë e llojet letrare që janë lëvruar gjatë tij. Përzgjedhja e veprave letrare që studiohen në këto tri vite bazohet në ruajtjen e një ekuilibri midis letërsisë shqipe dhe asaj botërore. Letërsia shqipe analizohet dhe krahasohet me letërsinë botërore, duke vënë në dukje ngjashmëritë dhe veçoritë dalluese mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë se letërsia shqipe nuk qëndron e shkëputur, por është pjesë e pasurisë letrare botërore.	- analizon tiparet kryesore të folklorit tonë, përshkruan origjinën dhe përmbajtjen e eposit kombëtar dhe vlerëson rëndësinë historike dhe kulturore të tij. - analizon tiparet kryesore të letërsisë antike greke dhe romake, të letërsisë së Rilindjes Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit. - përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues. - krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore. - gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.
---	--	---

V. PËRMBAJTJA MËSIMORE E KLASËS SË DHJETË

5.1 Koha mësimore në klasën e dhjetë


Lënda e letërsisë zhvillohet me dy orë mësimore në javë, gjithsej 72 orë në klasën e dhjetë. Koha mësimore përdoret për:

- analiza letrare dhe studime teksti;
- përsëritje;
- dramatizime;
- biseda letrare;
- testime;
- ese (dy ese);
- projekte;
- etj.

Analiza i veprave letrare (të plota) në program sugjerohet që të zhvillohet në 4-5 orë mësimore, ndërsa studimi i tekstit sugjerohet 1-2 orë. Në lëndën e letërsisë, gjatë çdo orë mësimi nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë të dyja kompetencat lëndore.

5.2 Përmbajtja mësimore e klasës së dhjetë

Në programin e letërsisë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Rezultatet e të nxënit janë pritshmëri të përgjithshme, të cilat shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh specifike për çdo klasë. Renditja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në program nuk nënkupton që përmbajtja mësimore përgjatë vitit shkollor, të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi, ndarja dhe e njohurive,



aftësive dhe qëndrimeve në kapituj apo grupe temash e njësi mësimore është e drejtë e përdoruesve kryesorë të programit, pra e mësuesve dhe e autorëve të teksteve shkollore.

Kompetenca “Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare”

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- interpreton, analizon dhe vlerëson elementet kryesore të përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, duke dalluar temën dhe motivet, idetë, përshkrimin e kohës dhe të mjedisit, rrëfimtarin, marrëdhëniet midis personazheve, si dhe strukturën e fabulës dhe të subjektit.
- interpreton, analizon dhe vlerëson një tekst poetik, duke identifikuar motivet dhe idetë kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës dhe veçori të tjera të formës artistike.
- interpreton, analizon dhe vlerëson një tekst dramatik, duke shqyrtuar mënyrën e trajtimit të temës, natyrën e konflikteve, marrëdhëniet mes personazheve dhe elemente të tjera të tekstit dramatik.
- dallon dhe vlerëson tiparet dalluese të secilës gjini letrare, duke kuptuar funksionin, mesazhet dhe vlerën e tyre artistike.

Njohuritë

Aftësitë

Letërsia dhe gjinitë letrare

- Funkcioni dhe vlera e letërsisë. Shkenca për letërsinë.
- Lidhja e letërsisë me artet e tjera.
- Ndarja letërsisë sipas gjinive dhe tiparet e tyre.

Letërsia dhe gjinitë letrare

Nxënësi:

- analizon funksionet dhe vlerat e letërsisë si lloj arti.
- përcakton objektin e studimit të shkencës për letërsinë dhe analizon drejtimet kryesore të kësaj shkençe.
- analizon lidhjet e letërsisë me artet e tjera.
- përcakton gjininë letrare së cilës i përket një vepër.
- analizon tiparet kryesore të gjinisë epike, lirike dhe dramatike dhe të llojeve të tyre.

- Karakteristikat kryesore të mitit, legjendës, poemës epike, përrallës, tragjedisë, komedisë dhe romanit. - Figurat stilistike: krahasimi, metafora, alegoria, personifikimi, simboli, epanastrofa, hiperbola, metonimia, anafora, aliteracioni.	- analizon karakteristikat e një miti, legjende, poeme, përralle, tragjedie, komedie dhe romani (vepra që studiohen të plota gjatë klasës së dhjetë). - krahason elemente letrare me mënyrën si trajtohen në film, teatër ose artet e tjera. - shprehet, në mënyra të ndryshme, për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim etj.
<i>Elementet e tekstit letrar</i> - Fabula, subjekti. - Personazhet. - Tema dhe motivet e veprës letrare. - Mjedis, koha dhe atmosfera. - Stili dhe gjuha.	<i>Elementet e tekstit letrar:</i> <i>Fabula dhe subjekti</i> Nxënësi: - tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti. - përcakton fabulën e një teksti. - dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të një teksti. - dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre. - dallon konfliktin/et në një tekst dhe vlerëson mënyrën se si zgjidhen ato në vepër. - analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë. - përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori (p.sh., një tregim është shkruar në formën e një letre, në një roman jepen ngjarjet në rend kronologjik etj.). - analizon disa aspekte të subjektit dhe ndikimin e tyre te lexuesit, si: ✓ struktura (p.sh., hyrja, zhvillimi, pika kulminante dhe përfundimi ose zgjidhja). ✓ teknikat narrative/e rrëfimit (p.sh., retrospektiva, kthesa e subjektit etj.).

	✓ konflikti dhe mënyra si ai e shtyn subjektin përpara. <i>Personazhet</i> Nxënësi: - analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet e tyre etj. - shpjegon qëllimet e personazheve. - analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh. - analizon ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.). - analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër. - dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, kryesorë, dytësorë). - shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh. - analizon zgjedhjet e autorit për të përshkruar personazhet (karakterizimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet përshkrimeve nga autori, karakterizimi i tërthortë nga veprimet, fjalët, mendimet, këndvështrimet e personazheve të tjera). - shpjegon se si arrihet karakterizimi nga autori duke analizuar ndryshimet dhe zhvillimin e personazheve. - vlerëson aspekte (ide, opinione, këndvështrime, veprime, zgjedhje etj.) të ndryshme të personazheve. - analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve. <i>Mjedisi, koha dhe atmosfera</i> Nxënësi:
--	--

	- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat). - analizon efektet e mjedisit dhe të atmosferës të lexuesit, duke përcaktuar se si përshkrimi fizik i mjedisit ngjall përjetime emocionale. - krahason mjedise të ndryshme brenda të njëjtit tekst ose në tekste të ndryshme. <i>Tematika</i> Nxënësi: - dallon temën dhe motivet e një teksti. - analizon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar. - demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës. - tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore. <i>Stili dhe gjuha</i> Nxënësi: - veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato të lexuesit dhe në tekst si p.sh.: ✓ gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve). ✓ përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofa, hiperbola, ironia etj.). ✓ muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.). ✓ rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë). ✓ toni (i gjallë, i zymtë, i ngrohtë, solemn). ✓ gjatësia e fjalëve, elipsa, asindeti etj.
--	--

	- përdor burime digjitale dhe formate multimodale (tekste online, audiotekste, video, harta interaktive) për të lexuar, interpretuar dhe krahasuar tekste letrare - vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara. <i>Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror</i> Nxënësi: - demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst. - shpjegon se si konteksti ndikon në tekst. - analizon zgjedhjet, këndvështrimet dhe idetë e autorit kundrejt kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik etj. <i>Lidhja mes tekstit dhe lexuesit</i> Nxënësi: - tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst. - analizon ndryshimet që ndodhin në bindjet dhe opinionet e tij, falë teksteve që lexon. - tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës dhe përvojës njerëzore. <i>Reflektimi ndaj tekstit</i> Nxënësi:
--	---

	- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën. - reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit. - shprehet, në mënyra të ndryshme, për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, recitime, interpretime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj. <i>Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve</i> Nxënësi: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti. - organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).
--	--

Kompetenca “Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike”

Leximi i plotë i veprave të përcaktuara si “Analizë vepre” është pjesë e domosdoshme e zhvillimit të kompetencës për vlerësimin e letërsisë shqipe dhe botërore

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- analizon tiparet kryesore të folklorit tonë, përshkruan origjinën dhe përmbajtjen e eposit kombëtar dhe vlerëson rëndësinë historike dhe kulturore të tij.
- analizon tiparet kryesore të letërsisë antike greke dhe romake, të letërsisë së Rilindjes Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit.
- përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues.

- krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore. - gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.	
Njohuritë	Aftësitë
Studim teksti “Epi i Gilgameshit” <i>(sugjerohet 2 orë)</i>	Epi i Gilgameshit Nxënësi: - shpjegon rëndësinë e Epi të Gilgameshit si një nga veprat më të hershme të letërsisë botërore. - lidh përmbajtjen e veprës me botëkuptimin dhe besimet e shoqërisë që e ka krijuar.
Letërsia klasike greke dhe romake <i>(sugjerohet 1 orë)</i> - Vështrim i përgjithshëm për letërsinë greke dhe romake. - Lindja dhe lulëzimi i epikës, lirikës dhe dramës. - Karakteristikat e secilës gjini letrare. - Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore.	Letërsia klasike greke dhe romake Nxënësi: - vlerëson rëndësinë e letërsisë greko-romake, si dhe analizon sfondin historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. - veçon llojet dhe gjinitë letrare që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe, si dhe përfaqësuesit dhe veprat kryesore.
Analizë vepre “Iliada” Homeri <i>(sugjerohet 5 orë)</i>	“Iliada” Homeri Nxënësi: - identifikon elementet e letërsisë gojore në poemën “Iliada”, si përsëritjet, epitetet e vazhdueshme, formulat tipike të rrëfimit gojor etj., duke i ilustruar me shembuj nga teksti. - analizon mënyrën se si “Iliada” pasqyron kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor të Greqisë së Lashtë.

	- shpjegon dhe argumenton ndikimin e “Iliadës” në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë botërore.
Analizë vepre “Prometeu i mbërthyer” Eskili <i>(sugjerohen 4 orë)</i>	“Prometeu i mbërthyer” Eskili Nxënësi: - shpjegon rëndësinë që ka “Prometeu i mbërthyer” në letërsinë botërore. - analizon mënyrën se si trajtohen temat universale të sfidimit të pushtetit dhe të sakrificës për të mirën e njerëzimit në veprën “Prometeu i mbërthyer”. - krahason idetë dhe temat e “Prometeu i mbërthyer” me situata, vlera dhe sfida të kohës sonë, duke treguar se si ato mbeten aktuale edhe sot.
Studim teksti “Gratë në parlament” Aristofani <i>(sugjerohen 2 orë)</i>	“Gratë në parlament” Aristofani Nxënësi: - shpjegon se si Aristofani, nëpërmjet “Gratë në parlament”, përdor komedinë për të vënë në lojë dhe për të kritikuar zakonet, ligjet dhe jetën politike të kohës. - analizon idetë dhe mesazhet për marrëdhëniet shoqërore, rolin e grave dhe konceptin e pushtetit në shoqërinë e kohës.
Folklori shqiptar <i>(sugjerohen 8 orë)</i> - Tiparet dhe vlerat e folklorit. - Llojet e krijimtarisë gojore. - Vlerat e lirikës popullore. - Epika popullore, nënndarjet, vlerat e saj.	Folklori shqiptar Nxënësi: - identifikon dhe analizon tiparet kryesore të folklorit, duke treguar rolin e tij si pasqyrë e jetës, zakoneve, botëkuptimit dhe identitetit të popullit shqiptar. - dallon, analizon dhe krahason llojet e krijimtarisë gojore shqiptare, duke evidentuar veçoritë, ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

- Analizë vepre “Eposi i Kreshnikëve”. - Studim teksti: Këngët legjendare të murosjes dhe/ose të rinjohjes dhe/ose të vëllait të vogël. - Studim teksti: Përrallë nga folklori.	- shpjegon qëllimin dhe funksionin që ka pasur çdo lloj krijimtarië gojore në jetën shoqërore dhe kulturore të shqiptarëve. - gjykon për vlerat artistike dhe mesazhet e lirikës popullore. - analizon llojet e epikës popullore dhe interpreton rëndësinë e saj, si ruajtëse e kujtesës historike dhe e vlerave në traditën shqiptare. - analizon vlerat historike, etike dhe shoqërore që përcjell “Eposi i Kreshnikëve” për jetën dhe botëkuptimin e shqiptarëve në të kaluarën. - analizon ngjashmëritë dhe dallimet tematike e strukturore të “Eposit të Kreshnikëve”, “Këngëve të Rolandit” dhe “Këngëve të Nibelungëve”, dhe analizon se si këto veçori pasqyrojnë botëkuptimin, idealet dhe jetën shoqërore të popujve që i kanë krijuar. - gjykon për vlerat artistike, zakonore, morale dhe kulturore që përcjellin këngët legjendare të murosjes, të rinjohjes dhe të vëllait të vogël, si pjesë e trashëgimisë shpirtërore shqiptare. - shpjegon se si këngët legjendare të murosjes, të rinjohjes dhe të vëllait të vogël kanë ndikuar në letërsinë e mëvonshme. - vlerëson funksionin edukativ dhe moral të përrallave popullore, në lidhje me botëkuptimin, përvojat dhe zakonet e popullit shqiptar. - gjykon se si njohuritë mbi folklorin shqiptar e ndihmojnë për të kuptuar më mirë identitetin, vlerat dhe marrëdhëniet shoqërore edhe në ditët e sotme.
Nga Mesjeta në Rilindje... (sugjerohen 5 orë) “Komedia hyjnore” Dante Aligieri	“Ferri” Dante Aligieri Nxënësi: - vlerëson rëndësinë e “Komedisë Hyjnore” si një nga veprat më të mëdha të letërsisë botërore.

Analizë veprë “Ferri” Dante Aligieri	- vlerëson rëndësinë që ka “Ferri”, si pjesë e “Komedisë Hyjnore”, në traditën letrare evropiane.
Rilindja Evropiane <i>(sugjerohet 1 orë)</i> - Vështrim i përgjithshëm rreth zhvillimit të Humanizmit dhe të Rilindjes Evropiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike. - Përfaqësuesit kryesorë në Evropë.	Rilindja Evropiane Nxënësi: - analizon zhvillimin e Humanizmit dhe të Rilindjes si periudhë që solli ndryshime të mëdha në letërsinë evropiane. - identifikon përfaqësuesit kryesorë të Rilindjes në Evropë dhe shpjegon rolin e tyre në zhvillimin e letërsisë.
Analizë veprë “Don Kishoti i Mançës” Servantes <i>(sugjerohen 4 orë)</i>	“Don Kishoti i Mançës” Servantes Nxënësi: - përshkruan momentet kryesore të jetës së Servantesit që kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimtarinë e tij letrare. - shpjegon mënyrën si filozofia e Rilindjes gjen shprehje në krijimtarinë e Servantesit. - analizon <i>donkishotizmin</i> si dukuri që ka lindur nga vepra e Servantesit dhe tregon si është shfaqur e shfaqet në kohë të ndryshme në shoqëri.
Analizë veprë “Hamleti” Shekspiri <i>(sugjerohen 5 orë)</i>	“Hamleti” Shekspiri Nxënësi: - vlerëson rëndësinë që ka “Hamleti” në letërsinë botërore si një nga tragjeditë më të njohura dhe më me ndikim të Shekspirit. - shpjegon pse temat dhe dilemat e Hamletit mbeten aktuale edhe sot, duke i lidhur me çështje të jetës dhe të shoqërisë bashkëkohore.

Letërsia e vjetër shqiptare (sugjerohen 9 orë) - Studim teksti “Meshari” Gjon Buzuku. - Analizë veprë “Historia e Skënderbeut” Marin Barleti. - Studim teksti “Apologjia e Skënderbeut” Frang Bardhi. - Studim teksti: Poezi nga Pjetër Budi. - Studim teksti: “Çeta e profetëve” Pjetër Bogdani	Letërsia e vjetër shqiptare Nxënësi: - shqyrton ndikimin historik dhe shoqëror të periudhës kur u hartua “Meshari” i Gjon Buzukut, duke nxjerrë në pah rolin e tij si dokument kryesor i shkrimit të gjuhës shqipe. - gjykon për vlerat artistike të veprës “Historia e Skënderbeut” të Marin Barletit, duke e vendosur në kontekstin e letërsisë evropiane të kohës. - evidenton rëndësinë e “Apologjia e Skënderbeut” të Frang Bardhit, si vepër që synon të mbrojë dhe të lartësojë figurën e Skënderbeut. - analizon motivet dhe vlerat artistike në poezitë e Pjetër Budit dhe i lidh me rrethanat historike të kohës. - shpjegon mënyrën si paraqiten çështjet fetare dhe përdorimi i gjuhës shqipe në “Çetën e profetëve” të Pjetër Bogdanit, duke e vendosur këtë vepër në zhvillimin e letërsisë së hershme shqipe. - shpjegon rolin e letërsisë së vjetër shqiptare për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të identitetit të shqiptarëve. - shpjegon pse është e rëndësishme të njihen dhe të ruhen veprat e letërsisë së vjetër shqipe, si pjesë e identitetit historik dhe kulturor të shqiptarëve.
Klasicizmi (sugjerohen 2 orë) - Vështrim i përgjithshëm. - Tiparet dhe parimet estetike.	Klasicizmi Nxënësi: - analizon tiparet dhe parimet estetike të klasicizmit. - veçon përfaqësuesit kryesorë të klasicizmit dhe veprat e tyre më përfaqësuese.

- Përfaqësuesit kryesorë. - Elemente të klasicizmit në letërsinë shqipe: studim teksti nga një vepër e Et'hem Haxhiademit.	- veçon disa elemente të klasicizmit në krijimtarinë e Ethem Haxhiademit.
Analizë vepre “Tartufi” Molieri <i>(sugjerohen 4 orë)</i>	“Tartufi” Molieri Nxënësi: - shpjegon mënyrën si Molieri, nëpërmjet komedisë “Tartufi”, kritikon hipokrizinë e shoqërisë së kohës. - tregon pse “Tartufi” vazhdon të ketë vlerë edhe sot, duke e lidhur me situata dhe fenomene të ngjashme në jetën bashkëkohore.

Vlerat dhe qëndrimet që zhvillon nxënësi në lëndën e letërsisë

Nxënësi:

- komunikon qartë dhe me gjuhë të pasur gjatë diskutimeve për veprat/ tekstet/fragmentet letrare.
- merr pjesë aktivisht në biseda dhe në diskutime për veprat që lexohen.
- respekton mendimet dhe interpretimet e bashkëmoshatarëve për letërsinë.
- dëgjon me vëmendje dhe tregon respekt kur të tjerët shprehin idetë dhe komentet e tyre.
- tregon interes për të zbuluar kuptime të reja në veprat/tekstet letrare.
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin në komentimin ose në interpretimin e veprave.
- përdor teknologjinë për të kërkuar informacione shtesë dhe për të përgatitur prezantime lidhur me letërsinë.
- punon me përgjegjësi si në detyra individuale, ashtu edhe në projekte ose analiza në grup.

- vlerëson kulturën dhe veçanërisht trashëgiminë letrare të popullit shqiptar.
- e çmon gjuhën standarde shqipe dhe e pasuron fjalorin e tij përmes leximit të letërsisë.
- shfaq vetëbesim dhe shpirt krijues kur interpreton ose shpreh mendimet e veta për tekstet.
- tregon pavarësi në të menduar dhe në nxjerrjen e përfundimeve nga leximet.
- bën pyetje të mençura dhe përgjigjet me kujdes e përgjegjësi për tekstet e trajtuara.
- bën kritika të argumentuara për idetë, temat ose stilin e shkrimit të autorëve.
- shfaq kureshtje për të hulumtuar më shumë rreth autorëve, periudhave letrare dhe veprave të tjera.

5.3 Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).

Në këtë rubrikë ofrohen disa shembuj orientues veprimtarish që ndihmojnë për të përmbushur një rezultat të nxëni në letërsi. Këta shembuj synojnë të tregojnë se si aftësitë dhe rezultatet mund të realizohen në procesin mësimor të letërsisë. Për hartimin e rezultateve të të nxënit për orë mësimore, mësuesi bazohet në aftësitë e përcaktuara në programin e letërsisë. Dallimi mes aftësisë së programit dhe rezultatit të të nxënit është:

Aftësia është një deklaratë e përgjithshme që tregon çfarë duhet të zhvillojë nxënësi gjatë një periudhe më të gjatë (p.sh.: grup orësh, muaj, periudhë vit ose nivel arsimor). Ajo është e gjerë dhe afatgjatë, pasi kërkon kohë dhe ushtrime të vazhdueshme për t'u arritur. Aftësia, gjithashtu, përshkruan sjelljen e synuar. Shembull aftësie në letërsi: *Nxënësi shpjegon rolin e ideve kombëtare në letërsinë e vjetër shqiptare për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të identitetit të shqiptarëve.*


Rezultati i të nxënit për një orë mësimore është një deklaratë konkrete dhe e matshme që tregon çfarë do të arrijë nxënësi në fund të një ore mësimore. Ai është i ngushtë dhe i përqendruar në një qëllim të caktuar, është i matshëm dhe i verifikueshëm brenda orës, si dhe bazohet në një pjesë të asaj aftësie të madhe nga programi lëndor. Rezultatet e të nxënit hartohen nga vetë mësuesi. Shembull rezultati të nxënit në letërsi: *Nxënësi shpjegon pse “Meshari” i Gjon Buzukut konsiderohet një vepër që ka ruajtur gjuhën shqipe dhe ka ndihmuar në krijimin e vetëdijes kombëtare.*

Rezultati i të nxënit	Veprimtaritë
<i>Nxënësi shpjegon pse “Prometeu i mbërthyer” i Eskilit konsiderohet një vepër me vlera universale dhe si lidhet ajo me sfidat dhe idealet e njerëzve edhe sot.</i>	Më poshtë janë dhënë disa veprimtari që mund të zhvillohen me nxënësit e klasës së dhjetë: <i>Diskutim: “Çfarë e bën Prometeun një figure të guximshme?”</i> - Mësuesi zgjedh një fragment ku Prometeu shpall hapur se do të ndihmojë njerëzit, edhe pse e di ndëshkimin që e pret. Mësuesi pyet klasën: “Çfarë fiton Prometeu nga kjo sakrificë? Çfarë tregon kjo për karakterin e tij?”. <i>Punë në grupe me fletë pune: “Si lidhet Prometeu me botën e sotme?”</i> Nxënësit krahasojnë figurën e Prometeut me shembujt e sotëm që sfidojnë padrejtësinë ose pushtetin për të mirën e shoqërisë. - Nxënësit ndahen në çifte ose në grupe të vogla. Ata marrin një fletë pune ku duhet të shkruajnë: ✓ Një veprim të Prometeut që sfidon pushtetin për të ndihmuar të tjerët. ✓ Një shembull nga ditët tona (aktivist, gazetar, qytetar) që bën diçka të ngjashme. ✓ Një fjali ku krahasojnë të dy rastet. <i>Shkrim reflektues: “Çfarë më mëson Prometeu mua?”</i> Nxënësit lidhin idetë universale të veprës me jetën e tyre dhe shprehin mendimin personal. Ata shkruajnë një paragraf të shkurtër me temën: “Prometeu më mëson se...” ku shpjegojnë se çfarë kuptojnë nga historia e tij për guximin drejtësinë, ose sakrificën. Pastaj 2-3 nxënës e lexojnë para klasës.

	<i>Debat i strukturuar: “A ia vlen të sfidosh pushtetin?”</i> Nxënësit arsyetojnë dhe shprehin argumente <i>pro</i> ose <i>kundër</i> temës, duke u bazuar në veprën e Eskilit dhe në përvojat e tyre. Klasa ndahet në dy grupe. - Njëri grup mbron idenë se Prometeu kishte të drejtë të sfidonte Zeusin, - Grupi tjetër mbron se nuk ia vlente të rrezikonte aq shumë për të ndihmuar njerëzit, pasi pasojat ishin shumë të rënda. - Çdo grup përgatit 2-3 argumente dhe i prezanton. - Në fund bëhet një diskutim i shkurtër i hapur për të parë nëse dikush ka ndryshuar opinion. <i>Aktivitet krijues: “Simboli i Prometeut”</i> Nxënësit kuptojnë thelbin e mesazhit të veprës përmes simbolikës dhe shprehin në mënyrë krijuese idenë e sakrificës dhe të guximit. - Nxënësit vizatojnë një simbol për Prometeun (p.sh.: zinxhirë të thyer, një flakë ose një figurë që sfidon një dorë të madhe që e shtyp). - Poshtë vizatimit shkruajnë një fjali ku tregojnë se çfarë përfaqëson ky simbol për ta.
--	---

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e letërsisë do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES



Kjo rubrikë e programit përshkruan parimet, strategjitë dhe metodat që drejtojnë zhvillimin e orëve të letërsisë, duke u mbështetur në përvoja të suksesshme arsimore dhe në qasje moderne të mësimdhënies. Qëllimi është të mundësohet edukimi letrar dhe estetik i nxënësve, të zhvillohet mendimi i tyre kritik e krijues dhe të ndërtohet një lidhje e qëndrueshme dhe e thellë me veprat letrare.

6.1. Parimet e mësimdhënies së letërsisë

Që mësimdhënia e letërsisë të jetë e suksesshme dhe të arrijë të zhvillojë te nxënësit shijen estetike, mendimin kritik dhe respektin për trashëgiminë letrare shqiptare dhe botërore, është e nevojshme që mësuesi të mbështetet në disa parime të rëndësishme didaktike. Këto parime ndihmojnë të krijohet një proces i gjallë, ku nxënësit angazhohen, diskutojnë, krahasojnë dhe i lidhin veprat letrare me botën e tyre dhe me realitetin bashkëkohor.

Parimi i kontekstualizimit

Mësuesi ndihmon nxënësit të vendosin tekstin ¹letrar në kontekstin e periudhës historike, kulturës, shoqërisë dhe botëkuptimit ku është shkruar. Në të njëjtën kohë, nxënësit udhëzohen të lidhin temat ose mesazhet e teksteve letrare me situata të ngjashme në jetën e tyre dhe në shoqërinë e sotme. Kjo e bën interpretimin më kuptimplotë dhe personal.

¹ Në këtë program, termit “teksti letrar” dhe “vepra letrare” përdoren në mënyrë plotësuese: “teksti letrar” i referohet çdo materiali/ fragmenti letrar që analizohet në procesin mësimor, ndërsa “vepra letrare” përdoret për të theksuar krijimin e plotë, me vlerë estetike, brenda traditës së letërsisë kombëtare dhe botërore.

Parimi i integritetit

Të gjitha aftësitë e të kuptuarit dhe të të shprehurit: leximi analitik, interpretimi, diskutimi, shkrimi reflektues dhe krijues, zhvillohen në mënyrë të ndërlidhur. Nxënësit analizojnë tekstin, diskutojnë në klasë, shkruajnë ese ose komente, duke i ushqyer këto aftësi reciprokisht. Përveç kësaj, letërsia lidhet me arte të tjera (muzikë, film, pikturë) dhe lëndë të tjera mësimore që e pasurojnë të kuptuarit.

Parimi i mësimdhënies me nxënësin në qendër

Procesi mësimor ndërtohet duke pasur parasysh interesat, përvojat, pjekurinë dhe stilin e të nxënit të nxënësve. Ata inkurajohen të shprehin interpretimet e tyre, të formulojnë pyetje dhe të ndërtojnë qëndrime të pavarura mbi veprat, duke i bërë tekstet pjesë të përvojës së tyre personale.

Parimi i orientimit drejt procesit

Gjatë procesit mësimor, theksi nuk duhet të vihet vetëm te përfundimi (p.sh., analiza ose shkrimi i esesë përfundimtare), por në të gjithë procesin: nga leximet e para, nënvizimi i figurave stilistike, diskutimet në grup, hartimi i tezave dhe argumenteve, deri tek rishikimi dhe përmirësimi i mendimeve të shkruara. Kjo i ndihmon nxënësit të ndërtojnë strategji të qëndrueshme të të menduarit dhe të të shkruarit për letërsinë.

Parimi i ndërveprimit dhe diskutimit të hapur

Diskutimet në klasë, debatet mbi zgjedhjet dhe veprimet e personazheve ose krahasimet ndërmjet veprave, u japin nxënësve hapësirë për të ndarë mendime dhe për të zhvilluar tolerancë ndaj këndvështrimeve të ndryshme. Gjatë procesit mësimor, mësuesi duhet të nxitë respektin, dëgjimin aktiv dhe pjesëmarrjen e çdo nxënësi.

Parimi i zhvillimit spiral

Njohuritë, konceptet dhe aftësitë letrare rikthehen dhe thellohen në nivele më të larta kompleksiteti gjatë viteve të arsimit të mesëm të lartë. Për shembull, motivi i rebelimit mund të shihet te Prometeu, pastaj te Hamleti dhe më vonë të krahasohet me personazhe të letërsisë moderne, duke ndërtuar kështu një kuptim gjithnjë më të ndërlikuar e më të plotë për letërsinë.

Parimi i gjithëpërfshirjes dhe i respektit për diversitetin

Çdo nxënës duhet të ndihet i vlerësuar dhe i përfaqësuar në orët e letërsisë. Mësuesi zgjedh tekste që reflektojnë perspektiva të ndryshme shoqërore, kulturore apo gjinore dhe krijon një klimë të hapur ku mendimet e të gjithëve dëgjohen. Gjithashtu, mësuesi diferencon qasjet sipas nevojave të nxënësve, duke ndihmuar secilin të arrijë më të mirën e tij.

6.2. Metodatat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave letrare

Zbatimi i programit mësimor kërkon që mësuesi të përdorë një shumëllojshmëri metodash dhe teknikash të menduara mirë, të cilat krijojnë klasa miqësore, gjithëpërfshirëse dhe sfiduese për nxënësit. Këto metoda janë të domosdoshme për të nxitur kuptimin e thelluar të teksteve letrare, formimin e shijes estetike, të mendimit kritik e krijues, si dhe për të ndërtuar tek nxënësit aftësinë për të shprehur gjykime të argumentuara.

Për të mbështetur zhvillimin e kompetencave letrare dhe të kompetencave kyç, mësuesi duhet të përdorë metoda dhe teknika mësimore që:

- nxisin analizën dhe interpretimin e teksteve nga këndvështrime të ndryshme, duke nxitur pyetje, krahasime dhe lidhje kuptimore brenda tekstit dhe mes teksteve.
- krijojnë mundësi për diskutime dhe debate që forcojnë argumentimin, respektin për mendime e këndvështrime të ndryshme dhe tolerancën ndaj interpretimeve të të tjerëve.
- krijojnë hapësira për shkrime reflektuese dhe krijuese, në të cilat nxënësit përpunojnë idetë dhe emocionet që ngjall teksti letrar.
- i ndihmojnë nxënësit të lidhin letërsinë me jetën, me përvojat e tyre personale dhe me realitetin bashkëkohor, duke i bërë tekstet më të afërta dhe të kuptueshme.

Në këtë proces përdoren teknika dhe metoda të ndryshme të të nxënësit aktiv dhe të të menduarit të thelluar, si: *stuhi mendimi, lexim ose dëgjim i drejtuar (DLTA), parashikim me terma paraprakë, lojë me role, rrjet diskutimi, klaster, diagrame (si ai i Venit, piramidale, harta e mendjes, pema e problemit), INSERT, “Di/dua të di/mësova më shumë”, ditari dypjesësh, kubimi, debati, imagjinata e drejtuar, dallimi i fakteve nga opinionet, gjashtë kapelat për të menduarit, shkrimi krijues me kufizime, “Çfarë nëse...”, tregimi pamor, ruaje fjalën e fundit për mua, si dhe korniza të skeletëzuara të mësimin.*

Këto metoda dhe teknika mësimore ndihmojnë nxënësit:

- të interpretojnë në mënyrë të argumentuar tekstin letrar, duke dalluar strukturën, temat, motivet, figurat stilistike dhe elemente të tjera artistike.
- të krahasojnë personazhe, situata dhe ide në tekste të periudhave ose kulturave të ndryshme.
- të organizojnë informacionin në mënyrë vizuale dhe konceptuale, duke e kategorizuar sipas kriterëve të ndryshme.
- të mbledhin të dhëna dhe shembuj nga teksti ose burime të tjera, për të ndërtuar interpretime të besueshme dhe të mbështetura.
- të shprehin gjykime të pavarura dhe të argumentuara mbi tekstet letrare.
- të propozojnë zgjidhje krijuese për dilemat, konfliktet ose çështjet që ngrenë tekstet.
- të zhvillojnë mendimin kritik për dukuritë e trajtuara në letërsi dhe t'i lidhin ato me realitetin dhe përvojat e tyre.

6.3. Elementet që do të studiohen në tekstet letrare

Mësimdhënia e letërsisë në arsimin e mesëm të lartë mbështetet në një qasje ku teksti letrar vendoset në qendër të procesit mësimor. Elementet që studiohen janë pikërisht ato që ndërtojnë dhe i japin veçantinë një teksti letrar. Këto elemente formojnë së bashku një strukturë të ndërlidhur, e cila shërben si bazë për t'i nxitur nxënësit të interpretojnë, të analizojnë, të reflektojnë dhe të vlerësojnë kuptimet estetike, shoqërore dhe filozofike që përcjell letërsia.


Këto elemente nuk duhen trajtuar të ndara apo të izoluara, por si pjesë përbërëse të së njëjtës përvojë letrare. Rendi në të cilin paraqiten më poshtë nuk tregon rëndësinë apo shkallën e tyre të vështirësisë. Duhet pasur parasysh gjithashtu se jo të gjitha këto elemente gjenden domosdoshmërisht në çdo tekst letrar; për shembull, një poezi lirike mund të mos ketë personazhe të ndërtuar me tipare të plota.

Elementet kryesore që interpretohen, analizohen dhe vlerësohen në tekstet letrare janë:

- *Fabula dhe subjekti:* Përfshijnë ngjarjet, ndodhitë dhe mënyrën si ato lidhen ndërmjet tyre për të ndërtuar strukturën narrative të tekstit. Nxënësit mësojnë të dallojnë zhvillimin e fabulës dhe të identifikojnë momentet kyç të subjektit.

- *Personazhet*: Nxënësit analizojnë mënyrën e ndërtimit të personazheve, veprimet e tyre, marrëdhëniet me të tjerët, vlerën simbolike, si dhe tiparet emocionale, morale, sociale apo intelektuale që u jepen nga autori.
- *Koha, vendi, rrethanat dhe atmosfera*: Përfshijnë kohën dhe hapësirën ku zhvillohen ngjarjet, kontekstin ku vendosen ato, si dhe atmosferën – gjendjen emocionale që krijon kombinimi i kohës, mjedisit dhe rrethanave.
- *Tematika*: Përqendrohet në çështjet kryesore që trajton teksti letrar, në idetë themelore që autori dëshiron të përcjellë tek lexuesi.
- *Stili dhe gjuha*: Nënkupton përdorimin e qëllimshëm të mjeteve gjuhësore dhe stilistike nga autori, për të arritur efekte të caktuara estetike, për të përforcuar temat dhe për të ndërtuar individualitetin artistik.

Diagrami i mëposhtëm pasqyron lidhjen mes këtyre elementeve.



6.4. Autorët, veprat dhe fragmentet e sugjeruara në lëndën e letërsisë

Leximi dhe studimi i veprave letrare në klasën e dhjetë synon t'u ofrojë nxënësve njohuri letrare dhe një përvojë të pasur estetike, duke i aftësuar ata të kuptojnë, të analizojnë dhe të vlerësojnë tekste të ndryshme letrare. Për këtë qëllim, programi përfshin si leximin e veprave të plota, ashtu edhe studimin e fragmenteve ose teksteve të përzgjedhura, të cilat së bashku ndihmojnë në ndërtimin e kompetencave letrare dhe të kompetencave kyç. Në këtë kuadër bëhet dallimi midis:

- *Analizën e veprave të plota*, të cilat nxënësit i lexojnë tërësisht dhe për të cilat rekomandohet të planifikohen afërsisht 5 orë mësimi, për të mundësuar një analizë të gjithanshme të strukturës, temave, personazheve, stilit, gjuhës dhe elementeve të tjera artistike.
- *Studimeve të teksteve*, që përfshijnë fragmente ose pjesë të zgjedhura nga vepra të ndryshme. Këto përdoren për të njohur një motiv, një veçori artistike apo një problematikë të caktuar, dhe zakonisht trajtohen në më pak orë mësimore.

Përveç këtyre, mësuesit mund të përzgjedhin tekste të tjera të periudhës letrare ose të letërsisë bashkëkohore, të cilat mund të përfshihen në formën e projekteve ose të bisedave letrare, duke e pasuruar përvojën letrare të nxënësve dhe duke nxitur reflektimin e tyre personal.

6.5. Bisedat letrare

Përveç veprave të detyrueshme për t'u lexuar, këshillohet që, brenda një viti shkollor, të studiohen edhe 1-2 vepra për projekte ose biseda letrare. Orët për projekte ose biseda letrare, mësuesit duhet t'i vendosin në planin e tyre mësimor, kur të bëjnë zbërthimin analitik të programit. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t'u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

Veprat e rekomanduara për projekte ose biseda letrare duhet të jenë:

- nga letërsia shqipe ose nga letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e projekteve ose e bisedave letrare nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare së nxënësve.

6.6. Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e letërsisë

Projektet kurrikulare janë veprimtari të strukturuar mësimore që synojnë të zhvillojnë kompetencat letrare dhe kompetencat kyç të nxënësve përmes detyrave të integruara, kuptimplota dhe sfiduese, që kërkojnë bashkëpunim, hulumtim dhe krijimtari.

Në lëndën e letërsisë si në çdo lëndë tjetër mësimore, projektet mund të jenë lëndore ose ndërlëndore, duke ndërthurur njohuri dhe aftësi letrare me njohuri dhe aftësi nga fusha të tjera të artit, gjuhëve, historisë, filozofisë, shkencave të natyrës, teknologjisë etj.

Në lëndën e letërsisë, projekti kurrikular është një aktivitet i strukturuar afatgjatë, që shtrihet përgjatë vitit shkollor dhe zë një numër të caktuar orësh të parashikuara në planin mësimor. Ai nuk është thjesht një detyrë ose ushtrim i zakonshëm, por një proces i plotë mësimor që i përfshin nxënësit në mënyrë aktive, krijuese dhe bashkëpunuese. Ai i angazhon nxënësit të punojnë në grupe ose individualisht, të përdorin teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK), të lidhin letërsinë me botën reale dhe të krijojnë produkte të dukshme, që mund të jenë:

Rëndësia e projekteve kurrikulare në lëndën e letërsisë

- *Zhvillimi i kompetencave letrare dhe gjuhësore:* Nxënësit përmirësojnë të lexuarin me kuptim, interpretimin, analizën dhe vlerësimin përmes veprimtarive praktike që kanë në qendër tekstin letrar.
- *Nxitja e mendimit kritik dhe e mendimit krijues:* Nxënësit mësojnë të vlerësojnë, të krahasojnë, të krijojnë interpretime dhe ide të reja mbi veprat letrare, duke përdorur të menduarit kritik për të trajtuar dilema estetike dhe morale.
- *Zhvillimi i pavarësisë dhe i përgjegjësisë personale:* Projektet i inkurajojnë nxënësit të ndërmarrin iniciativa, të menaxhojnë kohën dhe të ndërtojnë vetëbesimin në kompetencat e tyre interpretuese dhe krijuese.
- *Përfshirja aktive dhe puna në grup:* Përmes projekteve, nxënësit mësojnë të ndajnë mendime, të bashkëpunojnë dhe të respektojnë perspektivat e ndryshme që lindin gjatë analizës së teksteve.
- *Integrimi i njohurive dhe i përvojave:* Nxënësit krijojnë lidhje mes përmbajtjes së veprave letrare dhe jetës së tyre të përditshme, duke e parë letërsinë si pjesë të kulturës dhe identitetit të tyre.

- *Zhvillimi i aftësive për hulumtim dhe prezantim:* Nxënësit aftësohen të kërkojnë informacione mbi autorët, periudhat letrare ose temat universale dhe t'i prezantojnë ato në mënyrë të argumentuar e tërheqëse, duke përdorur gjithashtu forma të ndryshme multimediale.

Disa shembuj projektesh në lëndën e letërsisë

Video interpretuese: Nxënësit lexojnë një vepër të plotë (p.sh. “Hamleti”) dhe përgatisin një *trailer* ose video interpretuese 2-3 minuta, ku shfaqin vizualisht konfliktin kryesor, atmosferën, personazhet etj., duke përdorur aplikacione për montazh (CapCut, iMovie, Canva Pro). Projektet prezantohen në klasë dhe nxënësit diskutojnë zgjedhjet e bëra (muzikë, tekst, imazhe) si mënyrë për të theksuar idetë dhe ndjesitë që mbart vepra.

Revistë digjitale letrare: Klasa organizohet në grupe që përgatisin një revistë online ku përfshihen:

- ese ose lloje të tjera shkrimesh.
- intervista të imagjinuara me personazhe letrare.
- ilustrime të skenave kryesore.
- etj.

Profili në media sociale i një personazhi letrar: Nxënësit krijojnë një profil Instagram ose media tjetër sociale për një personazh letrar (p.sh. Hamletin ose Don Kishotin), ku bëjnë postime (story, reels) që tregojnë dilemat, ndjenjat, “komentet e miqve” dhe pasqyrimin e tij në botën moderne. Diskutojnë si ndryshon mesazhi i veprës kur paraqitet me gjuhën dhe formën e rrjeteve sociale.

Harta kulturore e letërsisë: Grupet realizojnë një hartë digjitale ku tregojnë vendet dhe periudhat historike të veprave të lexuara gjatë vitit. Bashkëngjisin citate, foto, referenca të autorëve dhe përshkruajnë ndikimin e kohës dhe vendit në veprën letrare.

Rishkrimi dhe interpretimi i një scene: Nxënësit zgjedhin një skenë dramatike ose një kapitull të një vepre të lexuar dhe e rishkruajnë atë duke e vendosur në një kontekst tjetër kohor (p.sh. “Hamleti” në një qytet modern me telefonata e mesazhe). Pastaj e interpretojnë para klasës, duke përdorur edhe mjete multimediale (skenografi, sfond me muzikë etj.).

6.7. Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e letërsisë

Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e letërsisë kërkon një mësimdhënie të diferencuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila merr në konsideratë nevojat individuale të çdo nxënësi. Ky proces fillon me njohjen e specifikave të nxënësit dhe me hartimin e planit edukativ individual (PEI), në bashkëpunim me mësuesin ndihmës, psikologun, stafin e shkollës dhe, sipas rastit, me specialistët e qendrave burimore.

Në kontekstin e letërsisë, kjo do të thotë të përdoren metoda, teknika dhe strategji të përshtatura që zhvillojnë aftësitë e të kuptuarit të tekstit letrar, të shprehjes së ndjenjave dhe ideve, të komunikimit dhe ndërveprimit, duke e bërë procesin mësimor të kuptueshëm, të arritshëm dhe motivues për çdo nxënë.

Disa mënyra për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara në letërsi janë:

- Përshtatja e materialeve mësimore, si tekste të thjeshtuara, me shkronja të mëdha, me figura shoqëruese ose me burime audio dhe pamore që ndihmojnë kuptimin e përmbajtjes letrare.
- Zgjedhja e detyrave të diferencuara, të cilat përputhen me nivelin e aftësive dhe stilet e të nxënit të secilit nxënë, për shembull përmes pyetjeve të drejtpërdrejta.
- Krijimi i një mjedisi mbështetës dhe inkurajues, ku nxënësit ndihen të sigurt të shprehin mendimet e tyre rreth veprave letrare dhe të marrin pjesë aktive pa frikë nga gabimet.
- Përdorimi i pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale, si lexues të zërit, programe që shfaqin tekstin me shkrim të madh ose me kontrast të lartë, ose mjete që ndihmojnë në organizimin e mendimeve (harta mendore).
- Integrimi i videove, ilustrimeve dhe regjistrimeve zanore të tregimeve, poemave ose pjesëve dramatike, për të përforcuar kuptimin dhe për të bërë tekstin më të afërt emocionalisht.
- Përdorimi i qasjeve shumë shqisore, që kombinojnë dëgjimin, shikimin dhe lëvizjen (p.sh. vizatimi i një personazhi ose i një skene letrare) për të lehtësuar përvetësimin.
- Përdorimi i shembujve konkretë dhe situatave nga jeta e përditshme, për të ndihmuar në kuptimin e temave dhe mesazheve të tekstit letrar.

- Mbështetja nga bashkëmoshatarët, përmes punës në çifte ose në grupe të vogla, që nxit bashkëpunimin, ndarjen e ideve dhe ndihmën reciproke. Disa shembuj veprimtarish të përshtatura për letërsinë janë:
 - Diskutime të thjeshta mbi tekstin, lojë me role, përshkrimi i fotove ose i ilustrimeve të personazheve, përdorimi i kartave me fjalë kyç për të ndihmuar në zhvillimin e të folurit.
 - Dëgjimi i tregimeve të thjeshtuara ose regjistrimeve zanore, të ndjekura nga pyetje të qarta për të kuptuar idenë kryesore ose ndjenjat e personazheve.
 - Leximi i teksteve të thjeshta të shtypura ose digjitale, të shoqëruara me figura që ndihmojnë në ndërtimin e kuptimit.
 - Shkrimi i fjalive të shkurtra, përgatitja e përshkrimeve të thjeshta për një personazh, për një situatë etj.

6.8. Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e letërsisë

Nxënësit e talentuar përbëjnë një grup të veçantë, me aftësi të theksuara në të menduarit kritik, analizën gjuhësore dhe krijimin letrar. Përfshirja dhe mbështetja e tyre në procesin mësimor është e rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e talentit të këtyre nxënësve, por edhe për krijimin e një klime mësimore sfiduese dhe frymëzuese për të gjithë klasën. Mësuesit duhet të krijojnë mundësi për nxënësit e talentuar që të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre, të shprehin kreativitetin dhe të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Puna me ta është e rëndësishme, pasi:

- Nxënësit e talentuar kanë nevojë për sfida dhe përmbajtje të avancuar që përputhen me aftësitë e tyre, për të arritur rezultate të larta.
- Përfshirja e nxënësve të talentuar në veprimtari komplekse dhe sfiduese rrit motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin mësimor.
- Këta nxënës shpesh kanë potencialin për të udhëhequr grupe dhe për të ndikuar pozitivisht në mjedisin e klasës.
- Nxënësit e talentuar marrin pjesë në konkurse, olimpiada dhe projekte që përfundojnë me arritje jo vetëm për ta, por edhe për mësuesit dhe shkollën.

Si mund të identifikohen nxënësit e talentuar?

- Kanë rezultate të shkëlqyera në teste, ese, punë me shkrim, projekte etj.

- Përvetësojnë shpejt konceptet dhe kanë aftësi për të lidhur njohuritë në mënyra krijuese.
- Kanë aftësi të theksuara për të analizuar dhe interpretuar tekstet dhe situatat gjuhësore.
- Kanë kreativitet dhe origjinalitet në shprehje.
- Shprehin interes dhe kuriozitet të vazhdueshëm për të lexuar, shkruar dhe eksploruar tema komplekse.

Si mund të punohet me nxënësit e talentuar?

- Dhënia e detyrave të avancuara dhe komplekse që kërkojnë mendim kritik dhe krijues.
- Përfshirja në projekte që kërkojnë udhëheqje dhe përgjegjësi më të larta.
- Përfshirja në debate, konkurse dhe prezantime publike për të ndarë njohuritë dhe talentin me të tjerët.
- Integrimi i platformave online dhe burimeve digjitale për të zgjeruar njohuritë.
- Analiza të thelluara të veprave letrare, interpretimi i mesazheve të fshehura dhe krijimi i eseve dhe tregimeve me përmbajtje origjinale.
- Organizimi i takimeve për të diskutuar për librat dhe për të ndarë mendime mbi autorët dhe krijimtarinë e tyre letrare.
- Nxitja për të marrë pjesë në konkurse letrare, festivale poetike, olimpiada dhe projekte që sjellin risi.

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e letërsisë do të përshkruhen të detajuara veprimtari praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

7. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e letërsisë është një pjesë e rëndësishme e procesit mësimor, pasi ndihmon të evidentohen niveli i përvetësimit të kompetencat letrare dhe të kompetencave kyç nga nxënësit, si dhe për të përmirësuar të nxënit e tyre. Qëllimi i vlerësimit në letërsi nuk është vetëm të vendosë një notë, por edhe:

- të ndihmojë nxënësin të kuptojë dhe të vlerësojë përparimin e tij në analizën, interpretimin dhe shprehjen e ideve mbi veprat letrare.
- t'i krijojë mundësi nxënësit të reflektojë mbi mënyrën se si lexon, kupton dhe e përjeton një tekst letrar.
- të orientojë mësuesin për të përshtatur metodat dhe strategjitë mësimore sipas nevojave të nxënësve dhe specifikave të klasës.
- të zhvillojë aftësitë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për të diskutuar dhe për të krijuar tekste letrare apo argumentuese, duke zhvilluar kështu ndjeshmërinë estetike dhe shijen letrare.

7.1. Parimet e vlerësimit në lëndën e letërsisë

Vlerësimi në lëndën e letërsisë mbështetet në një sërë parimesh që synojnë të nxisin përjetimin estetik, të thellojnë të kuptuarit e teksteve letrare dhe të përmirësojnë vazhdimisht procesin e të nxënit. Disa prej këtyre parimeve janë:

- *Vlerësimi mbështet të nxënit:* Vlerësimi nuk ka vetëm funksion matës, por shërben si mjet për të nxitur leximin me kuptim, për të përmirësuar interpretimin e veprave dhe për të zhvilluar aftësitë e mendimit kritik dhe krijues.
- *Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe i integruar:* Vlerësimi realizohet natyrshëm gjatë leximeve, diskutimeve, analizave dhe krijimeve letrare, jo vetëm në teste apo situata formale.
- *Vlerësimi bazohet në kompetenca:* Vlerësimi mat jo vetëm njohuritë rreth autorëve apo veprave, por sidomos aftësitë për të kuptuar, analizuar, interpretuar, gjykuar dhe vlerësuar tekstet letrare, si dhe për të shprehur ndjenja, qëndrime dhe mendime me ndjeshmëri estetike.
- *Vlerësimi është i drejtë dhe gjithëpërfshirës:* Vlerësimi merr parasysh ritmet, interesat dhe përvojat e ndryshme të nxënësve me tekstin letrar, duke promovuar pjesëmarrje të barabartë dhe përfshirje të plotë në procesin mësimor.

- *Vlerësimi është i kuptueshëm dhe transparent:* Nxënësit duhet të dinë qartë çfarë pritët prej tyre kur lexojnë, analizojnë apo krijojnë, dhe me çfarë kriteresh do të vlerësohen.
- *Vlerësimi nxit reflektimin dhe vetëvlerësimin letrar:* Nxënësit inkurajohen të analizojnë përvojën e tyre me tekstin, të identifikojnë pikat e forta dhe aspektet ku mund të përmirësohen në të kuptuarin dhe në shprehjen letrare.
- *Vlerësimi përdor teknika dhe instrumente të larmishme:* Në procesin mësimor përdoren nga diskutimet dhe analizat me gojë, te shkrimet analitike apo krijuese, projektet, prezantimet, deri te vlerësimi nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësimi.
- *Vlerësimi orienton mësuesin në përmirësimin e mësimdhënies:* Vlerësimi i jep informacion të vlefshëm mbi mënyrën si nxënësit lexojnë dhe kuptojnë, çfarë vështirësish kanë, duke e ndihmuar mësuesin të përshtatë metodat për të nxitur më shumë kuptim, analizë dhe përjetim estetik.

7.2. Llojet e vlerësimit në lëndën e letërsisë

Në lëndën e letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, përdoren lloje të ndryshme të vlerësimit që ndihmojnë nxënësit të thellojnë të kuptuarin e teksteve letrare, të zhvillojnë të menduarit kritik dhe të pasurojnë shprehjen e tyre. Këto vlerësime janë:

a) *Vlerësimi për të nxënë*

Vlerësimi për të nxënë ose vlerësimi formues, përdoret gjatë gjithë procesit mësimor për të monitoruar se si nxënësit po i kuptojnë tekstet letrare dhe për t'i ndihmuar ata të përparojnë në interpretim, analizë, vlerësim dhe krijim. Ky lloj vlerësimi nuk ka si synim vendosjen e notave, por shërben për të ofruar udhëzime që i drejtojnë nxënësit drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

Qëllimet e vlerësimit për të nxënë në letërsi janë:

- Zbulon boshllëqet në të kuptuarin e veprave letrare dhe i ndihmon mësuesit të përshtatin metodat për të thelluar analizën, interpretimin, vlerësimin etj.
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë gabimet ose keqkuptimet në leximin dhe analizën e teksteve, duke i bërë më të vetëdijshëm për mënyrën si lexojnë dhe si kuptojnë.

- Ofron të dhëna për mësuesin që të rregullojë qasjen/t e tij, të shtojë pyetje të tjera ose të ndalet më gjatë në elemente që nxënësit i kanë të vështira.
- I bën nxënësit të ndihen të motivuar për të përmirësuar arritjet e tyre.
- Nxit reflektimin dhe vetëvlerësimin e nxënësve mbi mënyrën si kuptojnë dhe interpretojnë letërsinë.
- Ndhmon nxënësit të njihen me kriteret e një leximi dhe analize të mirë, si dhe të mësojnë nga interpretimet e bashkëmoshatarëve.

Disa teknika të vlerësimit për të nxënë në lëndën e letërsisë janë:

- Komentet për esetë ose shkrimet e tjera analitike, përmes udhëzimeve hap pas hapi.
- Pyetjet gjatë diskutimeve për të kuptuar nivelin e të lexuarit dhe të interpretimit.
- Detyra të shkurtra ku nxënësit analizojnë një fragment ose japin mendimin e tyre mbi një figurë stilistike.
- Vetëvlerësime ku nxënësit reflektojnë mbi kuptimin e një vepre ose të një teme.
- Vëzhgime të diskutimeve në grup, ku nxënësit ndajnë interpretime të ndryshme të të njëjtit tekst.

b) Vlerësimi i të nxënit

Vlerësimi i të nxënit është një formë e vlerësimit që përdoret në fund të një niveli mësimor, të një viti shkollor, të një periudhe ose të një grupi orësh për të matur nivelin e njohurive dhe të aftësive që nxënësit kanë arritur në të kuptuarin, analizimin, interpretimin, vlerësimin e teksteve letrare.

Qëllimet e vlerësimit të të nxënit janë:

- Të përcaktojë nivelin e të kuptuarit, të analizës kritike, të interpretimit dhe vlerësimit të veprave letrare nga nxënësit, pas përfundimit të një grupi orësh, periudhe, viti, niveli arsimor.
- Të vendosë nota që pasqyrojnë nivelin e njohurive, aftësive, vlera dhe qëndrimeve.
- Të ndihmojë mësuesit dhe shkollën të analizojnë rezultatet për të reflektuar mbi qasjet e tyre mësimore dhe për të përmirësuar procesin mësimor.

- Të ofrojë të dhëna të qarta mbi arritjet e nxënësve për prindërit, për stafin mësimor dhe për vendimmarrësit në arsim.

Disa teknika të vlerësimit të të nxënësve janë:

- Ese dhe analiza të shkruara, ku nxënësit tregojnë aftësinë për të interpretuar, krahasuar dhe vlerësuar tekste letrare.
- Prezantime të projekteve letrare, ku nxënësit shpalosin njohuritë dhe aftësitë e fituara për autorë, periudha apo tema të caktuara.
- Teste përmbyllëse, me pyetje me alternativa, të hapura ose të strukturuar, që matin të kuptuarin e elementeve themelore të veprave dhe të fragmenteve të studiuara.
- Testime standarde, të cilat tregojnë arritjeve e nxënësve në kompetencat letrare në provimet kombëtare, edhe në krahasim me standardet ndërkombëtare.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë dallimet mes vlerësimit për të nxënë dhe vlerësimit të të nxënësve.

Vlerësimi për të nxënë	Vlerësimi i të nxënësve
Realizohet gjatë gjithë procesit të mësimdhënies.	Realizohet në fund të një grupi orësh, të një kapitulli, të një periudhe mësimore ose të një niveli arsimor.
Ofrohen reagime dhe komente për përmirësim.	Ka për qëllim vendosjen e notave ose të një vlerësimi përfundimtar.
Përqendrohet në zhvillimin dhe në përmirësimin e nxënësve.	Përqendrohet në matjen e performancës së nxënësve.
Përdoret për të përshtatur ose për të përmirësuar qasjet, metodat dhe teknikat mësimore.	Përdoret për të marrë vendime në lidhje me nivelin e njohurive ose të aftësive të nxënësve.

c) *Vlerësimi diagnostikues*

Vlerësimi diagnostikues është një lloj vlerësimi që bëhet në fillim të një procesi mësimor (niveli arsimor, viti shkollor, kapitulli, orësh mësimore) me qëllim që mësuesi të kuptojë nivelin e njohurive, aftësive dhe nevojave të nxënësve. Ai i ndihmon mësuesit të përshtatin metodat dhe teknikat e tyre mësimore për të mbështetur më mirë nxënësit.

Qëllimet e vlerësimit diagnostikues janë:

- *Identifikimi i njohurive dhe i aftësive ekzistuese të nxënësve:* Me anë të këtij vlerësimi përcaktohet se çfarë dinë nxënësit mbi një temë/grup temash të caktuara.
- *Zbulimi i dobësive në të nxënë:* Ky vlerësim u krijon mundësi mësuesve të identifikojnë vështirësitë që nxënësit mund të kenë nga vitet/ kapitujt/ orët e mëparshme.

Më poshtë janë dhënë disa instrumente të vlerësimit diagnostikues:

- Një test i shkurtër për të parë njohuritë dhe aftësitë kryesore të nxënësve mbi një lëndë ose mbi një grup temash mësimore.
- Pyetje të hapura për të parë sa kanë përvetësuar ose janë të familjarizuar nxënësit me njohuri dhe aftësi të caktuara.

Karakteristikat kryesore të vlerësimit diagnostikues:

- Nuk përdoret për të vlerësuar nxënësit me notë. Rezultatet e këtij vlerësimi nuk ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të nxënësit.
- Përdoret për të përmirësuar mësimdhënien. Mësuesit e përdorin për të identifikuar nivelin e nxënësve dhe për të ndërtuar punën e tyre në të ardhmen.
- Ndhmon në krijimin e planeve të personalizuara të të nxënësit dhe për të ndërtuar punë të diferencuar me nxënësit.

d) Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një proces në të cilin nxënësit reflektojnë mbi përparimin e tyre në të nxënë, vlerësojnë punën e tyre dhe identifikojnë pikat e forta dhe fushat ku kanë nevojë për përmirësim. Ky lloj vlerësimi ndihmon në zhvillimin e autonomisë dhe të përgjegjësisë për të nxënësit.

Qëllimet e vetëvlerësimit janë:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë se si mësojnë dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Gjithashtu ky vlerësim rrit ndërgjegjësimin e nxënësve për të nxënë.
- I nxit nxënësit të analizojnë punën e tyre, të reflektojnë dhe të marrin vendime për përmirësim.
- Rrit motivimin dhe përgjegjësinë e nxënësve. Duke vlerësuar progresin e tyre, ata ndihen më të angazhuar dhe më të motivuar për të arritur rezultate më të mira.
- Ndhmon në vendosjen e qëllimeve personale. Nxënësit mund të përcaktojnë qëllime të qarta dhe të punojnë për t'i arritur ato.
- Përmirëson vetëbesimin e nxënësve, i ndihmon ato të kuptojnë se janë të aftë të përmirësohen dhe të zhvillojnë një qasje më pozitive ndaj të nxënit.

Më poshtë janë dhënë disa teknika të vetëvlerësimit:

- Fletë reflektimi, ku nxënësit u përgjigjen pyetjeve si: *Çfarë kam mësuar? Çfarë më ka ndihmuar më shumë? Çfarë mund të bëj më mirë?*
- Vetëvlerësimi duke përdorur rubrika, ku nxënësit vlerësojnë punën e tyre sipas kritereve të përcaktuara.
- Ditaret e të nxënit, ku nxënësit mund të mbajnë shënime mbi arritjet dhe pikat e dobëta të tyre gjatë procesit mësimor.
- Vetëvlerësimi me shkallë vlerësimi, i cili u jep mundësi nxënësve të vlerësojnë veten duke përdorur një shkallë nga 1 në 5 ose nga “Jo mirë” në “Shumë mirë”.
- Krahasimi i një detyre të mëparshme me një të re për të parë përmirësimet dhe ndryshimet.
- Etj.

e) Vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

Vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri ose vlerësimi mes bashkëmoshatarëve është një proces në të cilin nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit duke u bazuar në kritere të qarta dhe objektive.

Qëllimet e këtij vlerësim janë:

- Nxënësit zhvillojnë aftësitë e të menduarit në mënyrë kritike. Ata mësojnë të analizojnë dhe të japin komente konstruktive mbi punën e tjetrit.

- U krijon mundësi nxënësve të ndihmojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin në procesin e të nxënës.
- Nxënësit bëhen më të vetëdijshëm për cilësinë e punës dhe për mënyrat se si mund të përmirësojnë punën e tyre.
- Nxënësit ndihen më të përfshirë dhe më të përgjegjshëm për cilësinë e mësimit të tyre.

Disa teknika ose instrumente të vlerësimit të nxënësve nga njëri-tjetri janë:

- *Dy pozitive dhe një sugjerim:* Nxënësit identifikojnë dy gjëra që janë bërë mirë dhe një aspekt që mund të përmirësohet nga tjetri.
- *Rubrikë vlerësimi:* Nxënësit përdorin një rubrikë të përgatitur nga mësuesi për të vlerësuar punën e shokëve të tyre.
- *Shkrimi i komenteve:* Nxënësit shkruajnë komente mbi punën e njëri-tjetrit duke përdorur pyetje si: *Çfarë funksionon mirë? Çfarë mund të përmirësohet? Çfarë sugjerimesh keni?*
- *Diskutimi në grupe të vogla:* Nxënësit ndajnë punën e tyre dhe komentojnë për punët e njëri-tjetrit në një mjedis bashkëpunues.

f) Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara duhet të sigurojë që ata të kenë mundësinë të shprehin njohuritë dhe aftësitë e tyre në përmbushje të rezultateve të të nxënës të planeve edukative individuale (PEI). Për këtë arsye, mësuesi duhet të përshtatë detyrat dhe veprimtaritë vlerësuese sipas mundësive dhe nevojave individuale të këtyre nxënësve.

Këto përshtatje mund të përfshijnë:

- Ndryshimin e formateve të pyetjeve dhe të përgjigjeve, si për shembull ofrimin e një versioni të thjeshtuar të një pyetjeje (bazuar në pika kryesore) në vend të një eseje të gjatë.
- Modifikimin e veprimtarive vlerësuese, duke thjeshtuar gjuhën e përdorur ose duke ndryshuar formatin e pyetjeve për t'iu përshtatur më mirë aftësive të nxënësit.
- Përshtatjen e procesit të vlerësimit, si dhënien e kohës shtesë, ofrimin e pushimeve të ndërmjetme apo përdorimin e teknologjive ndihmëse.
- Përshtatjen e udhëzimeve, duke i bërë ato më të qarta dhe të personalizuara për nxënës me vështirësi në komunikim ose nevoja të tjera specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për këta nxënës duhet të diskutohen në mënyrë të rregullt me prindërit dhe mësuesit ndihmës, duke siguruar që ata të jenë të informuar mbi ndikimin e këtyre përshtatjeve në procesin e vlerësimit dhe në përparimin e nxënësve.

7.3.Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve

Në këtë pjesë jepen *dy shembuj orientues* të niveleve të arritjes për dy rezultate të nxënë, me qëllim që të ofrohet një ide e përgjithshme për mënyrën e përshkallëzimit të arritjeve të nxënësve. Këta shembuj mund të shërbejnë si pikënisje për mësuesin në ndërtimin e kritereve të vlerësimit të nxënësve.

<i>Shembull 1. Rezultati i të nxënësve: Nxënësi shpjegon mënyrën si Moliere, nëpërmjet komedisë “Tartufi”, kritikon hipokrizinë e shoqërisë së kohës.</i>			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi shpjegon qartë dhe në mënyrë të argumentuar si Moliere në komedinë “Tartufi” kritikon hipokrizinë, me shembuj nga teksti.	Nxënësi shpjegon si Moliere kritikon hipokrizinë, duke dhënë disa shembuj nga komedia “Tartufi”.	Nxënësi tregon që “Tartufi” kritikon hipokrizinë, me lidhje të pjesshme me komedinë.	Nxënësi nuk shpjegon si kritikohet hipokrizia në komedinë “Tartufi”.
<i>Shembull 2. Rezultati i të nxënësve: Nxënësi analizon veçoritë e stilit të Shekspirit në tragjedinë “Hamleti”.</i>			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi analizon qartë dhe me shembuj veçoritë e stilit të Shekspirit të “Hamleti”..	Nxënësi shpjegon disa veçori të stilit të Shekspirit të “Hamleti”, me disa shembuj.	Nxënësi identifikon disa veçori të stilit të Shekspirit, por me pak ose pa shembuj nga “Hamleti”..	Nxënësi nuk tregon si shfaqen veçoritë e stilit të Shekspirit në “Hamleti”..

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e letërsisë do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të nxënësit.

7.4.Procedurat e vlerësimit në lëndën e letërsisë

Për vlerësimin në lëndën e letërsisë zbatohen udhëzimet ligjore për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë. Nxënësi vlerësohet:

- Për përgjigjet me gojë ose me shkrim në analizë veprë dhe në studim teksti.
- Në ese ose në punë të tjera me shkrim.
- Në biseda letrare.
- Në projekt.
- Në teste.
- Etj.

8. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE

Burimet dhe materialet mësimore në lëndën e letërsisë përfshijnë të gjitha mjetet që përdoren për të mbështetur të kuptuarit, analizën, interpretimin dhe vlerësimin e teksteve letrare, pra për të zhvilluar kompetencat letrare dhe kompetencat kyç. Ato ndihmojnë nxënësit të përjetojnë letërsinë në mënyrë të kuptimshme dhe të plotë. Dobitë kryesore të burimeve dhe materialeve në letërsi janë:

- Pasurojnë përvojën estetike të nxënësve me tekstin letrar dhe i nxisin të lexojnë e të mendojnë në mënyrë të pavarur.
- Sigurojnë saktësi dhe qartësi në analizat letrare, në krahasime midis veprave ose në studimin e periudhave letrare.
- Nxisin angazhimin aktiv të nxënësve.
- Mbështesin mësimin gjithëpërfshirës dhe të personalizuar, duke ofruar mundësi të ndryshme për nxënësit sipas stileve të nxënësit dhe interesave të tyre.
- Ndihmojnë në ndërtimin e një baze të qëndrueshme të njohurive, të cilat nxënësit i transferojnë më tej në analiza më të thelluara ose në krijime personale.

Burimet dhe materialet mësimore që mund të përdoren në letërsi janë:

- Teksti shkollor i letërsisë që shërben si bazë për studimin e autorëve dhe të veprave.
- Tekste të tjera letrare dhe joletrare (kritika) në botuara ose online
- Fjalorë të termave letrarë, antologji dhe analiza tekstesh, edhe në formë digjitale.
- Burime digjitale, si: platforma online për analiza letrare, video dhe dokumentarë mbi autorë e periudha letrare, regjistrime të leximit ose të recitimit artistik të poezive apo pjesëve të dramave, faqe dhe aplikacione për të ndërtuar harta mendore etj.
- Materiale të përgatitura nga mësuesi, si: fletë pune për analizën e fragmenteve, modele analizash, struktura për ese etj.
- Mjete pamore dhe grafike, si: tabela krahasuese të personazheve, skema të strukturës së një vepre etj.

Mësuesi i letërsisë i përzgjedh burimet dhe materialet në varësi:

- të rezultateve të të nxënit.
- të veçorive të nxënësve dhe të mjedisit të klasës.
- të përmbajtjes tematike dhe natyrës së tekstit (dramë, poezi, tregim etj.).
- të nevojës për larmi didaktike.

8.1. Përdorimi i teknologjisë në lëndën e letërsisë

Përdorimi i teknologjisë në lëndën e letërsisë shërben si mjet mbështetës dhe nxitës për të përmirësuar cilësinë e të nxënit, për të rritur motivimin e nxënësve dhe për të zgjeruar burimet e të nxënit përtej tekstit shkollor tradicional. Ajo ndihmon në zhvillimin e kompetencave përmes mjeteve ndërvepruese, mjediseve bashkëpunuese dhe formave të reja të krijimit dhe të përpunimit të teksteve. Disa nga format e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor janë:

- Përdorimi i platformave digjitale (fjalëkryqe interaktive, kuize, redakte online).
- Krijimi i prezantimeve me PowerPoint, Canva ose mjete të tjera ngjashme.
- Realizimi i projekteve kurrikulare ose ndërkurrikulare me përdorimin e teknologjisë.

- Leximi online, ku nxënësit lexojnë një tekst digjital, krijojnë një përmbledhje dhe e ndajnë përmes blogut të klasës ose forumeve digjitale.
- Dëgjimi i teksteve audio dhe shikimi i materialeve video.
- Përdorimi i mjeteve për bashkëpunim në kohë reale (Google Docs, Padlet etj) për të ndarë ide, për të redaktuar tekste në grup dhe për të diskutuar nxënësit me njëri-tjetrin.
- Kërkimi në internet për burime të përshtatshme letrare, duke mësuar njëkohësisht si të përzgjidhen, të vlerësohen dhe të citohen burimet e informacionit.

Mësuesi udhëzon përdorimin e teknologjisë jo si qëllim në vetvete, por si mjet për zhvillimin e kompetencave të lëndës. Ai kujdeset që përdorimi i saj të jetë i qëllimshëm, i sigurt dhe në përputhje me moshën dhe nivelin e nxënësve, duke ndërtuar një kulturë digjitale etike dhe të përgjegjshme. Në këtë proces, mësuesi nxit qasjen kritike dhe krijuese të nxënësve ndaj burimeve online dhe i udhëzon ata të përdorin teknologjinë për të ndërtuar kuptim, për të komunikuar në mënyrë të efektshme dhe për të bashkëpunuar me të tjerët në mjedise të sigurta digjitale.

8.2. Roli i bibliotekës së shkollës

Biblioteka e shkollës ndihmon në ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive të nxënësve, duke mbështetur të nxënit gjatë gjithë jetës. Ajo mbështet suksesin e nxënësve në të gjitha lëndët e kurrikulës, veçanërisht në lëndën e letërsisë, duke inkurajuar ata të lexojnë me pasion, të mësojnë të analizojnë dhe të interpretojnë tekste të ndryshme për të kuptuar dhe shijuar përmbajtjen, si dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre kërkimore dhe të përdorin në mënyrë efektive informacionin e mbledhur.

Biblioteka e shkollës u mundëson nxënësve:

- të zhvillojnë dashurinë për leximin, si për qëllime mësimore ashtu edhe për kënaqësi estetike.
- të zhvillojnë njohuri dhe aftësi lëndore duke përdorur tekste letrare.
- të zhvillojnë aftësitë për të qenë lexues të pavarur dhe për të menduar në mënyrë kritike.
- të kenë qasje në programe, burime dhe teknologji të integruara që mbështesin të nxënit.
- të kuptojnë dhe të vlerësojnë rolin e bibliotekës si burim për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Mësuesi i bibliotekës duhet të bashkëpunojë me mësuesit e letërsisë dhe të gjuhës shqipe ose të lëndëve të tjera për të hartuar dhe për t'u ofruar nxënësve detyra autentike që zhvillojnë aftësitë:

- për qasjen, përzgjedhjen, mbledhjen, përpunimin, vlerësimin kritik, krijimin dhe komunikimin e informacionit.
- për përdorimin e informacionit për të eksploruar dhe hetuar çështje, për të zgjidhur probleme, për të marrë vendime, për të ndërtuar njohuri dhe për të pasuruar jetën e tyre.
- për komunikimin e gjetjeve të tyre për audienca të ndryshme, duke përdorur formate dhe teknologji të ndryshme.
- për përdorimin e informacionit dhe të kërkimeve në mënyrë të përgjegjshme.


Mësuesit duhet të diskutojnë me nxënësit konceptin e pronësisë dhe rëndësinë e të drejtave të autorit.

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e letërsisë do të përshkruhet më hollësisht përdorimi i burimeve dhe materialeve mësimore përfshirë teknologjinë.

9. REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT

Programi i letërsisë bazohet në Kornizën Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikulën bërthamë, planin mësimor të gjimnazit, si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Evropian për arsimin. Si i tillë, ky dokument u shërben mësuesve të gjuhës shqipe, autorëve të teksteve shkollore, hartuesve të testeve kombëtare, prindërve dhe vetë nxënësve, si një udhëzues për përmbajtjen, organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.

Kjo rubrikë përmban disa rekomandime praktike për zbatuesit e programit, me synimin që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të tij dhe të sigurohet që të gjitha palët e përfshira të kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të lëndës së letërsisë, duke nxitur përdorimin e metodave bashkëkohore, përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme, zhvillimin e kompetencave lëndore dhe përfshirjen aktive të nxënësve në procesin mësimor.



Rekomandime për mësuesit

- Planifikoni mësimin duke respektuar ritmet, interesat dhe nevojat individuale të nxënësve, përfshirë ata me talente krijuese apo me vështirësi.
- Zhvilloni aftësitë e të lexuarit, të të shprehurit dhe të të menduarit kritik përmes punës me tekste të larmishme letrare, të përshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve.
- Nxisni dashurinë për letërsinë duke zgjedhur fragmente/ tekste cilësore.
- Krijoni mundësi ku nxënësit të diskutojnë dhe të shkruajnë rreth teksteve, duke zhvilluar aftësitë letrare.
- Përdorni metoda dhe teknika të të nxënësve aktiv, bashkëpunues dhe të personalizuar, që përfshijnë analiza, debate, diskutime, ese, projekte, prezantime etj.
- Jepuni nxënësve mundësi të përballen me tekste sfiduese, duke ofruar mbështetje dhe udhëzime që përmirësojnë arritjet për të gjithë.

- Zhvilloni aftësitë e të shkruarit, në lloje të ndryshme letrare e analitike, me komente të vazhdueshme për përmbajtjen, strukturën, formën, fjalorin dhe stilin.
- Përdorni vlerësimin formues dhe diagnostikues, përmes komenteve dhe detyrave, për të ndjekur përparimin dhe për të përshtatur procesin mësimor.
- Përdorni burime digjitale dhe mjete pamore që e bëjnë letërsinë më të afërt dhe më të kuptueshme.
- Siguroni një mjedis të nxëni të hapur dhe mbështetës, ku nxënësit ndihen të lirë të shprehin mendimet dhe opinionet e tyre për letërsinë.
- Përfshini prindërit si partnerë në nxitjen e leximit dhe të interesit për letërsinë.
- Përzgjidhni tekste që ushqejnë ndjeshmërinë estetike, identitetin kombëtar, vlerësimin për artin dhe që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më thellë përvojën letrare njerëzore.
- Kujdesuni për dimensionin socio-emocional, duke i ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi vetveten dhe botën nëpërmjet leximeve dhe diskutimeve.
- Mbështetuni gjithmonë në udhëzuesit kurrikularë të letërsisë, duke i përshtatur sipas kontekstit të klasës dhe të nxënësve tuaj.

Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Përshtatni tekstet shkollore të letërsisë sipas kurrikulës së re dhe zhvillimeve bashkëkohore në kurrikulën e letërsisë.
- Përfshini burime digjitale që mbështesin përvetësimin e njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve nga nxënësit.
- Siguroni libra për mësuesin me udhëzime pedagogjike, modele planifikimi, ide për vlerësim dhe për zbatimin e qasjeve me në qendër nga nxënësi.
- Përdorni materiale të larmishme: tekste letrare, burime digjitale, punime të nxënësve, modele analizash ose shkrimesh, që ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të lëndës.
- Lidhni përmbajtjen e letërsisë me lëndë të tjera mësimore dhe me situata nga jeta reale, për të nxitur të menduarit holistik dhe ndërlëndor.

- Përfshini në tekste shkollore pyetje dhe detyra që nxisin mendimin kritik, mendimin krijues dhe aftësi të tjera të nivelit të lartë, si dhe për zhvillimin e kompetencave kyç.
- Siguroni që tekstet të jenë gjithëpërfshirëse, të përshtatshme për moshën dhe të ndjeshme ndaj diversitetit kulturor, gjuhësor dhe aftësive të ndryshme të nxënësve.

Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Siguroni që testet të përmbajnë jo vetëm pyetje mbi njohjen dhe të kuptuarit e tekstit letrar, por edhe pyetje që kërkojnë analizë, interpretim, gjykim dhe mendim të pavarur.
- Hartoni pyetje që lidhin njohuritë mbi letërsinë me situata të jetës reale, duke nxitur reflektimin personal dhe ndërtimin e qëndrimeve ndaj vlerave njerëzore.
- Merrni parasysh diversitetin kulturor dhe përvojat e ndryshme të nxënësve, duke zgjedhur tekste dhe pyetje të qarta, të kuptueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- Respektioni ekuilibrin mes njohurive mbi tekstet, periudhat dhe autorët, dhe aftësive për të analizuar, krahasuar, interpretuar e vlerësuar veprat, jo thjesht për t'i riprodhuar.
- Përfshini pyetje ose kërkesa që vlerësojnë aftësitë e nxënësve për të shkruar ese ose punë të tjera me shkrim për tema që lidhen me letërsinë.
- Përgatitni modele testesh orientuese, që mësuesit t'i përdorin gjatë vitit shkollor për të ndihmuar nxënësit të aftësohen gradualisht për testimin kombëtar.

Rekomandime për prindërit

- Inkurajoni fëmijët të kuptojnë rëndësinë e letërsisë jo vetëm për qëllime mësimore, por si një mjet për të shprehur veten, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të kuptuar botën.
- Lexoni rregullisht me fëmijët dhe diskutoni për libra, tregime apo tema që nxisin të menduarit, ndjenjat dhe imagjinatën.
- Promovoni një qëndrim pozitiv ndaj letërsisë, duke theksuar rëndësinë e përpjekjes, këmbënguljes dhe mësimet nga gabimet.

- Bashkëpunoni me mësuesit për të ndihmuar fëmijët në aktivitete letrare, projekte ose veprimtari që lidhen me gjuhën, letërsinë dhe kulturën.
- Njihuni me qëllimet e lëndës dhe pritshmëritë e programit mësimor në mënyrë që të ndihmoni ose të mbështetni fëmijën tuaj në procesin e të nxënës.
- Siguroni që fëmijët ndihen të mbështetur dhe të motivuar, duke krijuar një mjedis të qetë dhe të pasur me letërsi në shtëpi, ku leximi, të folurit dhe dëgjimi vlerësohen dhe nxiten.

Rekomandime për nxënësit

- Merrni pjesë aktive në orët e letërsisë: lexoni me kuptim, diskutoni, shkruani dhe ndani mendimet tuaja për veprat letrare.
- Angazhohuni në projekte që lidhen me letërsinë dhe kulturën shqiptare, duke përdorur tekstin për të shprehur veten dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
- Bashkëpunoni me shokët për të krijuar analiza, ese apo prezantime të përbashkëta dhe për të reflektuar mbi idetë që dalin nga tekstet letrare.
- Jini kureshtarë: bëni pyetje kur nuk kuptoni dhe kërkoni ndihmë për të përmirësuar arritjet tuaja në lëndën e letërsisë.
- Përdorni mjete digjitale dhe burime online për të lexuar tekste të reja dhe për të ushtruar aftësitë letrare në mënyrë të pavarur.
- Vlerësoni letërsinë si mjet komunikimi, si pjesë e identitetit dhe trashëgimisë kulturore, që ju ndihmon të kuptoni më mirë botën dhe të përgatiteni për të ardhmen.

10. NDRYSHIME PËRMBAJTJESORE

Nr.	Njohuritë	Si?	Ndryshimet
1.	Epi i Gilgameshit	Njohuri të përgjithshme. Studim teksti	Është shtuar
2.	Letërsia klasike greke (<i>epika</i>). “Iliada” Homeri	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim
3.	“Prometeu” Eskili (<i>tragjedia</i>)	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim
4.	“Gratë në parlament” Aristofani	Njohuri të përgjithshme. Studim teksti	Është shtuar
5.	<i>Foklori shqiptar</i> - Eposi i Kreshnikëve - Këngët legjendare të murosjes, të rinjohjes dhe të vëllait të vogël - Përralla	Eposi i Kreshnikëve- analizë vepre Vështirimi krahasues me Këngët e Rolandit dhe me Këngët e Nibelungëve	Janë shtuar këngët legjendare dhe përrallat
6.	Nga Mesjeta në Rilindje, Komedia hyjnore “Ferri” Dante Aligeri	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim
7.	Rilindja dhe humanizmi evropian “Don Kishoti i Mançes” Servantes	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim
8.	“Hamleti” Shekspiri	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim
9.	Letërsia e vjetër shqiptare - “Meshari” Gjon Buzuku. - “Historia e Skënderbeut” Marin Barleti - vështirim së bashku me “Apologjia e Skënderbeut” të Frang Bardhit. - Analizë testesh poetike nga Budi. - “Çeta e profetëve” Pjetër Bogdani	Njohuri të përgjithshme. Analizë vepre “Histori e Skënderbeut” Marin Barleti Studime teksti nga Buzuku, Bardhi, Budi dhe Bogdani	Janë shtuar “Meshari” Buzuku, “Apologjia e Skënderbeut” e Frang Bardhit, “Çeta e profetëve” Pjetër Bogdani
10.	“Tartufi” Molieri	Analizë vepre	Nuk ka ndryshim